

## METANI: NUK KA ASNJË RAST, ASNJË MAGJISTRAT, QË E KA MERITUAR PROCEDIMIN DISIPLINOR DHE TË MOS JETË PROCEDUAR

Faqe 2-3

Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar 8 rekomandime për vitin 2025, të cilat lidhen me forcimin e efektivitetit të inspektimeve, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, bashkëpunimin ndërinstitucional, dixhitalizimin e proceseve, analiza të ankesave të qytetarëve, komunikimin publik dhe vlerësimin publik të ndikimit të veprimtarisë inspektuese.



### ILD në shifra

**128 vendime nga 269 praktika të trajtuara:**  
97 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar  
31 vendime arkivimi pas verifikimit

**43 vendime verifikimi**

### Qytetari në Zyrën e ILD-së

#### Gjatë muajit Korrik 2026:

- Janë pritur **38 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Janë realizuar **22 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- Janë trajtuar **13 kërkesa** për informacion.



Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Z. Artur Metani, në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikqyrjen Institucionale

Fq. 4-12



Dialog i nivelit të lartë mbi përgjegjshmërinë gjyqësore dhe standardet e inspektimit

Fq. 13-18

Fjala e ILD në takimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë

Fq. 19-20

KLP pranon kërkesën e ILD për procedim disiplinor ndaj prokurores A.K

Fq. 22

Sesioni i pyetje- përgjigjeve të ILD-së në Komisionin për Çeshtjet ligjore dhe Administratën Publike

Fq. 23-33

## FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI NË KOMISIONIN PËR NISMAT QYTETARE, BASHKËPUNIMIN DHE MBIKËQYRJEN INSTITUCIONALE



Faleminderit Zoti Xhafaj për fjalën,

Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar 8 rekomandime për vitin 2025, të cilat lidhen me forcimin e efektivitetit të inspektimeve, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, bashkëpunimin ndërinstitucional, dixhitalizimin e proceseve, analiza të ankesave të qytetarëve, komunikimin publik dhe vlerësimin publik të ndikimit të veprimtarisë inspektuese. Në vlerësim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të 8 rekomandimet janë të plotësuara. Kisha përgatitur diçka më të përgjithshme, por meqë u adresuan specifikuat të përfunduar, do të doja t'i merrja edhe unë specifikuat.

**Rekomandimi 1.** Hartimi i një formati periodik raportimi për zbatimin e rekomandimeve të inspektimeve, me tregues të matshëm. Është përmbushur plotësisht sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse ka miratuar urdhrin përkatës që përmban rregulla dhe procedura për raportimin e zbatimit të rekomandimeve me tregues sasiorë dhe cilësorë, në funksion të garantimit të efektivitetit të inspektimeve.

**Rekomandimi 2.** Përfshirja e inspektimeve vijuese si pjesë e planifikimit vjetor të inspektimeve dhe parashikimin e burimeve përkatëse për realizimin e tyre. Edhe kjo është e përmbushur sipas relatorit, por edhe sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Rekomandimi 3.** Inicimi i një protokollit bashkëpunimi ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Prokurorinë e Përgjithshme, për të mundësuar akses në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive. Në zbatim të rekomandimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar bashkëpunimin e rregullt me dy Këshillat dhe Prokurorinë e Përgjithshme, duke ofruar të dhëna, sqarime, si dhe përfaqësim në grupet e punës për zhvillimin e sistemeve të reja informatike.

Në kuadër të projektit EU4Digital Justice (EU4DJ) janë zhvilluar takime me UNOPS dhe Prokurorinë e Përgjithshme për identifikimin e nevojave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me aksesin e inspektorëve në sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve. ILD ka qenë proaktive, si në përcjelljen e kërkesave për të dhëna, ashtu edhe në pjesëmarrjen në diskutimet për zgjidhjet teknike të aksesit në sistemin. Me ftesë të KLGJ-së, përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë marrë pjesë në të gjitha takimet teknike për përcaktimin e nevojave të institucionit për qasje në sistemet e gjykatave dhe prokurorive. Aktualisht zhvillimi i sistemit elektronik, apo sistemeve elektronike është ende në proces dhe arkitektura teknike përfundimtare nuk është e konsoliduar. Në këtë kuadër hartimi i një protokollit formal, nuk do kishte asnjë efekt të shtuar për sa kohë që është garantuar angazhimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për paraqitjen e nevojave dhe njëkohësisht edhe aksesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistemet ekzistuese të gjykatave, ARKID dhe ICMIS ku të gjithë inspektorët dhe ndimësinsektorët kanë akses të plotë në përputhje me parashikimet ligjore duke siguruar respektimin e parimeve të ligshmërisë, transparencës dhe sigurisë së informacionit.

**Rekomandimi 4.** Të zhvillohen konsultime me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim identifikimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes inspektimeve tematike. Në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë me shkresën nr. 3286 prot., datë 14.11.2025, duke kërkuar propozime për tematika inspektimi për vitin 2026, në përputhje me praktikën e ndjekur edhe ndaj institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë. Deri në momentin e raportimit nuk është marrë përgjigje dhe nuk janë paraqitur propozime apo problematika konkrete nga ana e këtij institucioni. Në këto kushte, sa i takon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rekomandimi konsiderohet i përmbushur, jo vetëm për këtë shkak,

por edhe sepse në vijimësi të gjitha ankesat që vijnë nga qytetarë që përfaqësohen me avokatë janë adresuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, jo vetëm individualisht, por edhe në hartimin e tematikave të inspektimeve institucionale apo tematike, të veçanta. Gjithashtu kur ka pasur adresime institucionale ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, siç ka qenë rasti i Dhomës së Avokatisë, Shkodër apo Dhomës së Avokatisë, Sarandë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është përgjigjur me masa konkrete. Në rastin e kërkesave konkrete të Dhomës së Avokatisë, Shkodër magjistrati për të cilin më parë kishte ankesë, u procedua disiplinarisht, ndërsa në rastin e Sarandës kërkesat e paraqitura nga Dhoma e Avokatisë, Sarandë iu nënshtruan inspektimit tematik, i cili po vijon. Kështu, që në këtë pikë mendoj që raporti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Dhomën Kombëtare të Avokatisë ka qenë mëse korrekt, institucional dhe në respekt të dinjitetit Kushtetues që ka institucioni.

**Rekomandimi 5.** Të merren masa për krijimin e një sistemi për menaxhimin e çështjeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim që të digjitalizohen proceset e shqyrtimit të ankesave, verifikimit dhe hetimit, për të përmirësuar eficiencën, reduktuar vonesat dhe ndihmuar ndjekjen në kohë reale të ankesave. E zbatuar, edhe sipas relatorit.

**Rekomandimi 6.** Të hartohen raporte periodike analitike mbi tematikat e ankesave të qytetarëve, me qëllim identifikimin e prirjeve kryesore të problematikave. Plani i inspektimeve tematike për vitin 2025, i miratuar nga Mbledhja e Përgjithshme të Inspektorëve reflekton fenomenet e evidentuara gjatë shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, personave juridikë dhe institucioneve të parashikuara në nenin 194, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, ku vendin kryesor e zënë pretendimet lidhur me zvarritjen e gjyqimeve dhe vonesat në zbardhjen e vendimeve nga magjistratët. Në funksion të formalizimit të këtij procesi dhe në zbatim të rekomandimit të Kuvendit, është miratuar Urdhri nr. 148, datë 31.12.2025, i cili përcakton të dhënat që duhet të përmbajnë raportet analitike mbi tematikën e ankesave, si dhe periodicitetin e hartimit të tyre. Pra rekomandimi është përmbushur.

**Rekomandimi 7.** Të zgjerohet dhe forcohet veprimtaria ndërgjegjësuere e komunikimit institucional përmes fushatave tematike dhe përmbajtjeve edukative të përshtatura me publikun e gjerë, duke synuar rritjen e njohjes së të drejtave të qytetarëve dhe rolit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përmirësuar ndërveprimin qytetar-institucion dhe duke rritur besimin tek mekanizmat e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

Në kuadër të këtij rekomandimi është hartuar programi i edukimit ligjor, informimit dhe sensibilizimit të qytetarëve për vitin 2026–2027, i cili përmbledh detyrimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, i miratuar në janar 2026, duke u shtrirë në një periudhë 3-vjeçare.



Pas miratimit të Rezolutës për vitin 2025, janë zhvilluar disa aktivitete kryesore, përfshirë organizimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të një aktiviteti mbi inspektimin disiplinor në Shqipëri, prezantimin e botimit “Historik i përgjithshëm i procesit disiplinor”. Gjithashtu janë zhvilluar takime me nxënës të gjimnazëve në Tiranë dhe me pjesëmarrës të Akademisë së Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN) mbi modulën “Shteti i së Drejtës”. Janë bërë takime edhe në shkollë 9-vjeçare në Përmet. Në vijimësi takimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me publikun apo bërthama të organizuara të shoqërisë, siç janë shkollat jashtë Tiranës kanë qenë intensive. Për ne rekomandimi është i përmbushur. Për të mos folur pastaj për faqen zyrtare të institucionit që është plot me informacion dhe është një nga faqet më transparente sa i takon aktivitetit dhe veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Rekomandimi 8.** Të përgatitet deri në dhjetor 2025 analiza, që edhe relatori ra dakord që është përmbushur. Në lidhje me rekomandimet e propozuara për vitin 2026, natyrisht ne s’patëm kohë as t’i shikojmë. Unë kam parë, ose Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve ka parë rekomandimet e propozuara nga Komisioni i Ligjeve me të cilat kemi rënë dakord. Në lidhje me propozimet që vijnë nga ky Komision, kemi nevojë t’i shohim edhe një herë në mbledhjen e përgjithshme të inspektorëve dhe për t’iu përgjigjur padyshim me shkrim, edhe shpejt. Dy-tre gjëra që arrita të fiksoj, një nga gjërat është kalendari për punësimin e inspektorëve. Tani unë e kuptoj, padyshim që çështja e inspektorëve është çështje themelore, sepse pa inspektorë nuk ka si të bëhen edhe 15 rekomandimet e tjera, por çështja është se sa i takon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ne kemi marrë çdo masë që proceset e konkurimeve për inspektorë, si për ata magjistratë, si për ata jomagjistratë të jenë në afate kohore të ngushta. Këshillat shpallin gati, ndoshta dy herë në vit, shpallen për gjyqtarë dhe prokurorë dhe nuk ka asnjë aplikim. Në këtë pikë çfarë kalendarësh mund të propozoj unë, për shembull. Një gjë tjetër që fiksova, rritja e cilësisë së përgjigjeve të mos jenë formale, edhe qytetarëve t’i përgjigjemi për çdo pretendim. Nuk e di pse ka dalë ky shqetësim, se ky shqetësim nuk ka ardhur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të doja një gjë më konkrete, sepse një nga gjërat që na kritikojnë në fakt partnerët ndërkombëtarë kur na monitorojnë punën, është që përgjigjet dhe hetimet disiplinore janë të gjata. Pra gjëra të tilla ndoshta ka nevojë, që ndoshta edhe ne t’i shohim me kujdes. Prandaj po them që kam nevojë t’i diskutoj edhe me inspektorët në mbledhjen e përgjithshme të tyre, rekomandimet që ju keni propozuar në përputhje me atë që padyshim ju mendoni që duhet bërë. Për atë që padyshim mund të bëhet brenda 6 muajsh, që kanë ngelur deri në fund të vitit. Padyshim brenda kompetencave që ne kemi dhe problematikave që ne hasim çdo ditë.

Këto kisha për këto dy materiale kryetar.



## METANI: NUK KA ASNJË RAST, ASNJË MAGJISTRAT, QË E KA MERITUAR PROCEDIMIN DISIPLINOR DHE TË MOS JETË PROCEDUAR



**Sesioni pyetje përgjigjeve të ILD në komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale**

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Siç thamë, zoti Inspektor, deputetët kanë të drejtën e pyetjes; ju keni të drejtën e përgjigjes. Një minutë kemi caktuar si rregull, të kuptohemi, për secilën nga pyetjet. Dhe në fund, mbas fjalës tuaj, vetëm atëherë deputetët mund të ndërhyjnë. Do të thotë që ju jeni të lirë të vazhdoni të përgjigjeni, por në fund fare mund të bëjnë një koment lidhur me përgjigjet e marra. Ky është metodologjia që kemi zbatuar në gjithë këtë proces. Po, zoti Asalla, fjala për ju, ju lutem.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Po. Unë i kam të përmbledhura në 3 grupe pyetjesh, po themi, në lidhje me rritjen e stokut të ankesave dhe kapacitetin real për trajtimin e tyre. Cilat janë shkaqet konkrete, që gjatë vitit 2025, ILD trajtoi më pak ankesa sesa numri i ankesave të reja të depozituara? Sa ankesa janë të papërfunduara prej më shumë se 1, 2 ose 3 vjetësh? Dhe cila është koha mesatare e trajtimit të një ankese? Në lidhje me vakancat e inspektorëve dhe ndikimin mbi performancën: sa procedura rekrutimi ose komandimi janë zhvilluar dhe pse nuk kanë sjellë plotësimin e organikës? Dhe 2, çfarë masash kërkohen nga KLGJ dhe KLP për komandimin e magjistratëve? Dhe diçka tjetër: në lidhje me reformën në Drejtësi, kjo reformë nuk është bërë konkretisht për të mbrojtur gjyqtarët apo prokurorët, por për t'i bërë ata më të përgjegjshëm para ligjit dhe qytetarëve. Në ligjin, në ligjin edhe për ILD-në, neni, konkretisht neni 194, pika 3, thotë: "ILD heton shkeljet e dyshuara dhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Në kuadër të këtij neni, pyetja ime është: sa janë hetimet e shkeljeve kryesisht me bazë që ka nisur ILD-ja në bazë të këtij neni? Kaq kisha. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Faleminderit, zoti Hasalla. Zoti Metani, fjala për ju për përgjigjet.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** S'kisha ndezur unë mikrofonin, ndjesë. Pra, s'ka asnjë aplikim nga gjyqtarët. Kjo përsa i përket gjyqtarëve, për inspektorët magjistratë. Sa i takon inspektorëve jomagjistratë janë bërë 4 thirrje. Në 3 thirrjet, ka procese që zgjasin, sepse është një proces vetingu që kryhet gjatë rekrutimit dhe nuk varet nga puna e ILD, varet nga përgjigjja e institucioneve të tjera.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Janë mbyllur? I katërti është në proces?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Në 3 thirrje janë kryer verifikimet dhe i katërti është në proces. Në 2 thirrjet e para janë rekrutuar një numër inspektorësh, tek i treti nuk janë rekrutuar sepse kandidatët nuk u gjendën në përputhje me kriteret që parashikon ligji, apo vlerësimin profesional që ka bërë Komisioni Inspektorial i Drejtësisë në lidhje me kandidaturat. Jemi në pritje për shpalljen që do të mbyllet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por nuk besoj se do të ketë kërkesa nga gjyqtarët. Për hir të së vërtetës, unë e lidh këtë gjë edhe me çështjen e ligjit, Që para pesë vitesh kam kërkuar që raporti i ligjit me çështjen e punësimit, apo të komandimit të inspektorëve pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duhet të jetë minimalisht objekt debati, sepse ne patëm kërkuar ndryshime ligjore, e kam thënë disa herë edhe në Komisionin e Ligjeve, kur kemi bërë raportime. Unë e kuptoj që ka pasur një diskutim, sepse c'ka kërkohet është ndryshim sistemik nuk është thjesht çështje ulje kriteresh për magjistratët, që do komandoheshin apo do aplikonin për të qenë inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Por gjithsesi është një shqetësim që Zyra e ILD e ka, ose e kishte në propozimet që ne dërguam përpara se të bëheshin ndryshime ligjore. Duke qenë shumë dimensionale nuk u miratuan në kuvend, u miratuan disa prej tyre. Të shohim nëse këto ndryshime kanë pasur efikasitet, por thirrja e parë tregoi që nuk ka pasur një interes të shtuar nga magjistratë gjyqtarë, për pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Së dyti, në lidhje me faktin, nëse ka apo jo lidhje me ankesat, jo, atëherë në lidhje me ankesat. Në lidhje me (ishin tre pyetje) më pak ankesa. Janë trajtuar mesatarisht sa viti i kaluar, në mos më shumë. E para, e dyta është shtuar numri inspektimeve tematike dhe duke pasur këtë raport dhe duke vlerësuar raportin edhe me numrin e inspektorëve, që janë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mendoj që ky është vlerësimi që i duhet bërë shifrave. E treta, numri i ankesave në periudha të caktuara shtohet shumë. Nuk e di pse. Ndodh që për një tre muor, gati dyfishohet numri i ankesave, që vijnë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pra po flasim me shifra, për vitin 2024 kemi trajtuar 1374, ndërsa për 2025 kemi trajtuar 1635. Pra është rritur numri i ankesave të trajtuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ky është vlerësimi, që unë kam për këtë raport të ankesave që vijnë, me ato të trajtuara. Është e vështirë, që të matet koha e trajtimit të një ankese sepse varet nga shumë faktorë, kompleksiteti i çështjes, numri i magjistratëve për të cilët ankohet qytetari apo institucioni, faza në të cilën gjendet çështja për të cilën ankohet qytetari. Kështu që është e vështirë të bësh një... mund të shkojë nga një ditë deri në javë, në varësi edhe të përgjigjes që marrim nga institucionet, në lidhje me verifikimin e ankesave që bëjmë. Po dua ta theksoj këtu, që një lehtësi e madhe për verifikimin e shpejtë të ankesave ka qenë qasja në sistem, pra pas rekomandimit të kuvendit për qasje të ILD-së në sistemin e gjykatave. Kjo e shpejton shumë marrjen e informacionit dhe nuk ka nevojë më për shkresa, po i marrim drejtpërdrejt nga sistemi dhe kështu që jemi në gjendje që t'i përgjigjemi ankesave të qytetarëve më shpejt në kohë dhe pyetja tjetër sërish e lidhur me ankesat...Numri i ankesave, në momentin që jam zgjedhur Inspektor i Lartë i Drejtësisë, pra në 1 shkurt 2020, ku u ngrit institucioni, të ardhura nga institucionet e tjera ka qenë rreth 2200 ankesa. Deri në fund të vitit të parë shkoj 3300 apo 3.400, ndërkohë që në punë ishte vetëm Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe një inspektor tjetër. Dhe për këtë arsye, kur erdhën inspektorët e tjerë që u komanduan, inspektorët prokurorë, lindi nevoja e miratimit të një metodologjie për trajtimin e ankesave të prapambetura dhe atyre që vinin. U miratua metodologjia, duke i dhënë prioritet kohës dhe natyrës së çështjes, e kështu me radhë dhe pas kësaj metodologjie dhe pas punës së bërë, edhe backlogu u hoq në një kohë të mirë dhe tani jemi duke trajtuar, besoj në shtator, ne do fillojmë trajtimin e ankesave të vitit 2025, pra përfundon 2023 dhe 2024, jam i bindur edhe në korrik, po s'dua të them kështu, pra në shtator do fillojmë me trajtimin e ankesave të vitit 2025 dhe 2026. Në lidhje me hetimet, sa hetime janë nisur, sa kanë nisur me iniciativë? Atëherë për vitin 2025 dy janë nisur me iniciativë nga Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Dy. Dua të theksoj një gjë këtu, që kjo është një nga çështjet mendojmë më delikate, që ka Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo individualisht, por institucionalisht sepse duhet të ruajmë një raport të drejtë mbi atë që raportohet në media, me atë që realisht mund të përbëjë shkelje disiplinore të magjistratit, me atë që mund të përbëjë realisht një veprimtari e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe natyrisht raporti i pavarësisë së magjistratëve, sepse natyrisht ky institucion nuk është ideuar, konceptuar që të mbrojë pavarësinë e gjyqtarëve ndoshta sipas fjalëve tuaja, por Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në gjashtë vite ka respektuar rigorozisht protokolllin kushtetues dhe ligjor në raport me përgjegjshmërinë, përgjegjësinë e magjistratëve, në raport me pavarësinë e tyre. Nuk ka asnjë rast, as nga procedimet e kryera, as nga ankesat e trajtuara, që Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kolegji i Posaçëm i Apelit, apo në ato raste që ka pasur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut t'i ketë kthyer një akt, një vendim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si të paplotë, joprofesional apo jo në përputhje me ligjin. Këto ishin përgjigjet për pyetjet.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Po, keni kohë? Po.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Unë kur fola, nuk e kisha vetëm për ILD-në në veçanti, e kisha për të gjithë reformën në drejtësi në përgjithësi. Dhe për atë e cilësova që është bërë për t'i bërë prokurorët dhe gjyqtarët më të përgjegjshëm, në radhë të parë përpara ligjit, por edhe përpara qytetarëve. Kaq kisha. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Faleminderit. Jam i bindur që edhe Inspektori i Lartë është i vetëdijshëm për rolin e jashtëzakonshëm që ka në këtë aspekt. Kështu që besoj ndani të dy të njëjtin mendim, që Inspektori i Lartë, Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë, është krijuar pikërisht për t'i shërbyer anës tjetër të medaljes së përgjegjshmërisë, duke mbrojtur dhe respektuar pavarësinë e tyre, sigurisht.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Po.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Jo, jo, s'ka nevojë. S'është pyetje.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Jo, koment.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Jo, koment. Në fund mund ta bëni koment. Po, zoti Gjoni?

**Deputeti Gjin Gjoni:** Faleminderit, zoti Xhafa. Faleminderit, zoti kryeinspektor. Pyetjet e mia kanë të bëjnë në lidhje me atë të cilët normalisht Komisioni Evropian ka evidentuar. Vijnë problematikat e vakancave dhe mungesës së kapaciteteve. Nevojitet forcimi i mekanizmit të integritetit dhe inspektimit, dhe kërkohet rritja e efikasitetit të procedurave disiplinore. Janë 3 nga gjetjet, të cilët normalisht ekzistojnë. Në lidhje me këtë, unë kam disa pyetje të cilët kanë të bëjnë: volumni rekord i ankesave versus kapaciteteve njerëzore. Dhe në rastin konkret, rezulton që përballemi me një fluks të madh ankesash nga qytetarët, 3200 ankesa të trajtuara për shqyrtim, dhe një numër të kufizuar të inspektorëve, që në rastin konkret dhatë një sqarim që në rastin e inspektorëve magjistratë është shumë e vështirë, dhe në rastin e jo-magjistratëve nuk ka kërkesa, megjithëse keni bërë shpalljen.

**Deputeti Saimir Hasalla:** Ka pasur kërkesa.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Ka pasur, por nuk plotëson kriteret. Një pjesë, që të jemi...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Ta mbarojmë me pyetjet. Po pyetjet, në fund përgjigjeni ju.

**Deputeti Gjin Gjoni:** Dhe pyetja ime është: përveç ndryshimeve ligjore, juve si Inspektor i Lartë i Drejtësisë, a keni një mekanizëm tjetër në mënyrë që të bëhet më atraktive përfshirja e këtyre njerëzve dhe në mënyrë që të ulët numri i ankesave? E dyta është hendeku i madh midis ankesave dhe procedimeve disiplinore. Dhe kjo është një pikë tjetër, e cila ndeshet normalisht. Dhe unë e kuptoj që 1200 ankesa ju i keni arkivuar, sepse janë për themelin e çështjes, të cilët nuk është kompetenca juaj, pasi është e gjykatave më të larta. Po nga ankesat e tjera, të cilët janë ankesa individuale, gjithmonë, cilat janë problematikat të cilat ndeshim më shpejt?

Më shpesh është zvarritja e gjykimeve, është arsyetimi me vonesë i vendimit gjyqësor, apo janë çështjet e etikës dhe të integritetit profesional? Pyetja tjetër ka të bëjë me rezistencën ose mospranimin e kërkesave nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, që është një problematikë të cilën ndeshet. Në rastin konkret, a mos duhet përmirësuar puna dhe mënyra se si Inspektori i Lartë ose inspektorët përgjegjës të rrisin efikasitetin dhe mënyrën e investigimit procedural ose të hapave të tjerë, në mënyrë që kërkesat të bëhen të pranueshme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë? Dhe rastet e debateve të cilët janë bërë publike në Inspektorat, më fal, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, a ka vend që Inspektori i Lartë i Drejtësisë të fillojë një hetim disiplinor në rastin konkret? Sepse janë ngjarje të cilat normalisht dhe deri në momentin aktual, për një periudhë 6-vjeçare, ne nuk kemi parë as edhe një anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të jetë vënë përpara një inspektimi të tillë. Dhe pyetja e fundit: a kemi humbje të lidhje me inspektimet tematike. A keni zhvilluar inspektime tematike në lidhje me qëndrimet e gjykatave për veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe çështjeve të cilat kanë një efekt në besimin e publikut në drejtësi, që janë çështjet më të prekshme sot? Dhe a kemi raste të zhvillimit të procedimeve disiplinore nga gjyqtarët që zvarrisin pafund gjykimin e çështjeve dhe arsyetimin e tyre, të cilët besoj është një nga gangrenë shumë e madhe sot në çështjen e backlog-ut dhe të arsyetimit të vendimeve në sistemin e drejtësisë? Dhe pyetja e fundit: a kemi humbje të afateve procedurale për shkak të zvarritjeve të ankesave? Se ka një afat procedural. Kur fillohet, kur përfundohet dhe si vazhdohet, që mos të parashkruhet. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Po, faleminderit, zoti Gjoni. Zoti Inspektor, përgjigjet tuaja ju lutem, për secilën nga një minutë për secilën nga pyetjet e kolegut.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Atëherë, nga pyetja e fundit: nuk ka kalime afatesh procedurale sa i përket hetimeve disiplinore dhe procedimeve disiplinore, në asnjë rast. Në lidhje me pyetjen e parë: nuk ka mekanizëm tjetër, se si mund të ndikojë numrin e ulët numri i ankesave. Mekanizmi që gjejmë është, e para, një metodologji që të na shkurtojë afatet për të cilat trajtohen ankesat, siç ishte kjo qasja në sistem, për shembull, apo ankesat e përsëritura, apo çështje që nuk kanë të bëjnë me punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pra janë çështje që i takojnë organeve të tjera ndoshta, ose janë çështje në proces gjyqësor. Dhe unë mendoj që ka funksionuar, sepse vetë rritja e numrit të trajtimit të ankesave, nga 1300 e ca, në 1600 e ca, tregon padyshim një punë më të madhe të inspektorëve, në numër të kufizuar, siç thatë ju, dhe shoqëruar kjo edhe me rritjen e numrit të inspektimeve tematike. Dhe besoj biem dakord që inspektimi tematik është një super punë. Dhe kjo është një super punë që kryhet nga inspektorët, si në bazë të gjetjeve që nxjerr inspektimi, edhe në bazë të rekomandimeve që bën, për të adresuar problematikën që ka sistemi i drejtësisë në mënyrë sistematike. Dhe unë mendoj që kjo është një nga përpjekjet më të mëdha që i kanë sjellë grupi i inspektorëve prokurorë dhe jo magjistratë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në lidhje me hendekun midis procedimit disiplinor dhe numrit të ankesave, pra numri i lartë i ankesave, ndoshta e parë kështu nga jashtë, edhe unë do bija dakord me ju, por unë ndaj një tjetër mendim, me thënë të drejtën.

E para, sistemi i llogaridhënies së magjistratëve ka dy komponentë të mëdhenj. E para sistemi i përgjegjshmërisë, dhe e dyta, sistemi i përgjegjësisë. Sistemi i përgjegjshmërisë ka të bëjë me emërimin, apo hyrjen në shkollën e magjistraturës, emërimin nga këshillat, trajnimin nga shkolla e magjistraturës, promovimin, vlerësimin etikoprofesional nga këshillat, promovimin e gjyqtarëve pas kriterëve, prokurorëve mbas kriterëve, raportet që kanë brenda sistemit, pra roli që ka dhe duhet të luajë Gjykata e Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore, roli i jurisprudencës ndërkombëtare në unifikimin e standardeve që duhet të ketë gjyqësori, pushteti gjyqësor, sistemi i drejtësisë në Shqipëri, dhe më pas, natyrisht, këto shoqërohen edhe me kontrollin e pasurisë, apo kontrollin e tjera të figurës, që bëjnë institucionet e tjera. Më pas është sistemi i përgjegjësisë. Sistemi i përgjegjësisë që thotë: e para, përgjegjësi penale; e dyta, përgjegjësi civile në ato raste që parashikon; dhe e treta është përgjegjësia disiplinore. Pra, unë mendoj që duhet të funksionojë i tërë sistemi, dhe nuk mund t'i kërkohej sistemit apo organeve të caktuara, që të funksionojë hallka e fundit, pa funksionuar të gjitha hallkat para saj. Sepse kjo e kthen sistemin në lodhje dhe në stërmundim, jo vetëm të madh, por edhe në efekt antikushetues tek e fundit, sepse procedimi disiplinor nuk mund të zgjidhë hallet që ka sistemi sot, ose vetëm procedimi disiplinor. Është një kompleks faktorësh. E para. E dyta, hetimi disiplinor nuk është çështje emocionale. Pra, nuk varet nga emocioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo nga inspektori përgjigjës që ka trajtuar çështjen. Varet sipas kriterëve që ka përcaktuar ligji, edhe sipas standardeve që ka vendosur edhe Këshilli, në raportet që ne kemi çuar, kur kemi proceduar magjistratë. Trajtimi, vetë trajtimi i 1,600 e disa ankesave, tregon...

**Deputeti Gjin Gjoni:** 1200 janë të arsyetuara.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po, po, të gjitha, në qoftë se doni ju. Çështja është që nuk është ky diskutimi. Diskutimi është...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Zoti Inspektor, besoj se duhet t'i përgjigjeni në mënyrë etike kolegut.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Kërkoj ndjesë nëse...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Këtu nuk është "nëse doni ju". Këtu nuk...

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po ishte thjesht mënyrë të foluri...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Jo, jo. Po mirë, dakord. Mënyrën e të folurit do ta, do duhet ta shikoni. Siç ne jemi të kujdesshëm me ju.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po s'e kam vënë ndonjëherë në dyshim, po edhe mua s'ma ka vënë njeri në dyshim etikën time...Ok. Janë trajtuar 1650 ankesa. Do të thotë janë trajtuar 1650 praktika. Janë marrë nga gjykatat dhe prokuroritë. Janë marrë 1650 vendime, që i kanë shkruar në dorë dhe ankuesit, por edhe magjistratit, i cili i ka shpjeguar ankesën dhe qëndrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje me ligjin. Që do të thotë magjistrati, çdo magjistrat, këta 1600 që janë verifikuar, e kanë ndjerë që sistemi i llogaridhënies ndaj tyre funksionon.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Dhe jo domosdoshmërisht në hetim disiplinor, apo procedim disiplinor. Kjo është më e rëndësishme në këndvështrimin tim, që gjyqtarët të ndjejnë, që sistemi që monitoron punën e tyre në mënyrë kushtetuese funksionon më së miri. Nuk ka asnjë rast, që ka qenë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili t'i ketë shpëtuar përgjegjësisë disiplinore, kur e ka merituar atë. Asnjë rast. Këtë e verifikojnë, apo e mbështesin edhe ankesat që qytetarët kanë ndaj vendimmarrjeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë shkuar në Këshillin përkatës. Dhe në asnjë rast Këshillat nuk kanë vendosur që vendimmarrjet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë qenë të paplota në hetimin që ka kryer, apo në verifikimin që ka kryer, apo jo profesionale. Dhe për mua ky është standardi që do vlerësoja personalisht. Rezistencë nga Këshillat në raport me procedimet e kryera. Me thënë të drejtën, ne padyshim çdo vendim që merret nga Këshillat e diskutojmë me inspektorët, në kuptimin e gjetjes së një standardi, që ne ndoshta nuk e kemi vlerësuar. Në asnjë rast nuk kemi vlerësuar ndonjë mangësi në punën tonë dhe këtë e mbështesim jo vetëm me analizën që i bëjmë vetes, por edhe të gjitha procedimet disiplinore që Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dërguar në Këshilla, i janë nënshtruar një verifikimi nga inspektorët të Këshillit të Lartë Gjyqësor spanjoll. Dhe raporti që ata kanë bërë është në faqe. Dhe në të gjithë raportet disiplinore që ne i kemi dërguar Këshillit, sipas vlerësimit të këtyre inspektorëve jashtë institucioneve shqiptare, kanë qenë vetëm dy vërejtje për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. E para që raporti i hetimit disiplinor, pra kërkesa për procedim është shumë e gjatë. Dhe e dyta, ka të bëjë me një masë, që kërkon Inspektori i Lartë i Drejtësisë për uljen e pagës. Sipas inspektorëve spanjollë, kjo është një masë që ndoshta prek jo vetëm gjyqtarët, por prek edhe familjen e gjyqtarëve. Kështu që në këtë pikë, inspektori duhet të jetë më i kujdesshëm në kërkimin e kësaj mase. Dhe e treta, në asnjë rast, kur Këshillat kanë refuzuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk i është kthyer Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që hetimi është i paplotë. Është çështje vlerësimi dhe diskrecion i Këshillave në raport me masën përgjithësisht dhe jo me gjetjet që ka bërë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo me hetimin e kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

**Deputeti Gjin Gjoni:** Për inspektimin e korrupsionit në...!

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Në inspektimin tematik në lidhje me korrupsionin, apo pastrimin e parave? Ndoshta e kam thënë edhe në raportime të tjera, pra në komisionin tjetër, edhe vitin e kaluar. Por mënyra se si i hartojmë ne inspektimet, kalendarin e inspektimeve tematike, është kjo. E para, bëjmë një analizë të gjithë ankesave të ardhura. Pra, bëjmë një përmbledhje se për çfarë ankohen qytetarët më shumë, në mënyrë që t'i adresojmë edhe nëpërmjet inspektimeve tematike. Së dyti, i marrim mendim institucioneve të drejtësisë, siç janë Këshillat, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Drejtësisë. Jo në të gjitha rastet institucionet janë përgjigjur, por në çdo rast, në ato raste që janë përgjigjur, ne i kemi bërë përgjithësisht pjesë të kalendarit të inspektimeve, natyrisht duke balancuar edhe me kërkesat që vijnë nga institucionet e tjera, apo dhe nga numri i inspektorëve që kemi, me mundësitë që kemi, për të kryer një numër inspektimesh që t'i përfundojmë në kohë. Deri tani, numri i inspektimeve tematike ka ardhur në rritje. Çdo vit kemi nisur me 5, 6, sot jemi me 9 inspektime tematike, që shpresojmë t'i përfundojmë deri në fund të vitit.

**Deputeti Gjin Gjoni:** Procedimet për çfarë janë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Ndërsa kërkesa për... ajo kërkesa specifike, që pyetët për, nuk ka qenë pjesë e asnjë propozimi të ardhur, as nga institucionet që u jemi drejtuar për mendim, por as një fenomen i ardhur nga ankesat e qytetarëve. Thashë, qytetarët ankohen përgjithësisht për zgjatjen e proceseve gjyqësore, zbardhjen e vonesës së vendimeve, vendimmarrjen e padrejtë. Ka pasur dhe çështje etike dhe aty kemi ndërhyrë, apo çështje konflikti interesi, e kështu me radhë. Pra, nuk ka pasur një fenomen, që ne ta adresojmë nga ankesat për çështjet e korrupsionit, apo pastrim të parave.

**Deputeti Gjin Gjoni:** Për zvarritje keni thënë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po, procedimet për zvarritje, po. Ne kemi kryer edhe inspektime tematike, që kanë rezultuar edhe me procedime disiplinore, por edhe inspektime individuale, pra të ankesave të qytetarëve, të cilat kanë çuar padyshim edhe në procedime disiplinore. Për vonesat e përsëritura, kemi çuar 5 raste. Për mospërmbyllje të justifikuar ose të përsëritura të funksioneve gjatë gjykimit, janë 4 raste. Për veprime apo mosveprime të kryera nga magjistrati, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në proces gjyqësor, janë 3 raste. Dhe kështu me radhë. Por për vonesat e përsëritura, i kemi çuar me masa të rënda, madje edhe vjet çuam për masa të rënda. Këshilli nuk e gjeti me vend propozimin e bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në dy raste që çuam për zvarritje, apo zbardhjen me vonesë të vendimeve gjyqësore. Megjithatë, kjo është çështje e vlerësimit të Këshillit, në raport me atë që...mesazhin që duhet të japin institucionet bashkë, në raport me qytetarët, apo me qytetarët dhe prokurorët. Por kjo është çështje diskrecioni dhe nuk është çështje që mund t'i hyhet ndonjë vlerësimi të mëtejshëm.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Më falni. Po, zoti Gjoni keni të drejtën e komentit mbi përgjigjet e pyetjeve të...!

**Deputeti Gjin Gjoni:** Faleminderit zotit kryetar. Faleminderit zoti Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Nisur nga korniza kushtetuese, sot ju jeni institucioni, i cili jeni pika nevralgjike e sistemit të drejtësisë. Dhe normalisht, sot je institucioni më i fortë që duhet të ketë sistemi i drejtësisë sot në Shqipëri, të paktën sipas kornizës kushtetuese. Dhe të gjithë institucionet e tjera, duke filluar që nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dhe institucionet e tjera, normalisht përfshi edhe gjykatat speciale dhe SPAK-un, sot duhet të kenë një kontroll akoma më të madh nga pjesa e inspektorit. Të gjitha përgjigjet të cilat ti më dhe, deri në momentin aktualisht, ishin përgjigjet pak a shumë të karakterit teorik, shpjegim ligjor dhe kushtetues. Dhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me thelbin e problemit, nuk është se u prekën, për një arsye shumë të thjeshtë: se sot të ulësh me 15 ditë afatin e gjykimit të një çështje nga Gjykata e Shkallës së Parë deri në Gjykatën e Lartë, besoj që është një problem, i cili ka të bëjë në lidhje me perceptimin e publikut të besimit tek drejtësia. Dhe ky është një nga elementët kryesorë. Çështjet të cilat kanë të bëjnë me mosarsyetimin e vendimit, sepse zoti Xhafa ka qenë ministër i Drejtësisë dhe unë kam qenë gjykatës dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk kishte gjyqtar që të arsyetonte, po të kalonte më shumë se 6 muaj arsyetimi i vendimit, të shkonte për shkarkim. Dhe sot keni gjyqtarë që kanë edhe 1 vit, edhe 1 vit e sa, dhe kur vjen problemi, sot qëndrojnë në sistem. Dhe kjo krijon këtë perceptimin tek njerëzit.

*Sepse unë jam dakord që në çështjet që kanë të bëjnë me thelbin e gjykimin, nuk është kompetenca juaj. Por çështjet procedurale, çështjet e mënyrës së zvarritjes së backlog-ut, i cili është një nga problemet kryesore, dhe në takimin që kemi patur edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, një nga pikat kryesore që u ngrit aty, dhe zoti Xhafa e tha me të drejtë që çështja e Bashkimit Europian do jetë çështja e zvarritjes dhe e numrit të ngarkesës së madhe dhe vonesave, të cilat sot Gjykata Europiane e Drejtësisë do japë ndëshkime shumë të mëdha në raport me qytetarët të cilët do kenë ankesa. Një çështje tjetër, në lidhje me këtë verifikimin nga inspektori spanjoll, më the, mbi ç'bazë e keni? Keni ndonjë marrëveshje, keni ndonjë kuadër ligjor, keni ndonjë mekanizëm që juve, para se t'i çoni në Inspektoratin e Lartë të... më fal, në Këshill?*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po.

**Deputeti Gjin Gjoni:** *Se më duket me ç'kuadër ligjor juve merrni nga një institucion i një vendi tjetër, kur s'e keni të rregulluar me këtë. E keni thjesht...!*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Jo, jo, jo.

*Deputeti Gjin Gjoni: Jo, se më duket pak dhe të kesh vetëm 5 procedime, dhe ajo që është kryesorja, është që juve deri në momentin aktual nuk i dhatë përgjigje edhe në lidhje me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në lidhje me inspektimet. Ose me tematika të cilat kanë të bëjnë me mënyrën se si sillen në raport me... Faleminderit.*

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Faleminderit, zoti Gjoni. Keni sqarim pse u krijua një keqkuptim lidhur me këtë çështjen e Inspektoratit Spanjoll?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po, faleminderit, kryetar. Keqkuptim, se mund të ishte pyetje normale dhe jo koment. Megjithatë, ka një projekt Qeveria Shqiptare me Bashkimin Europian një projekt mbështetës për sistemin e drejtësisë, ai që quhet "EU4Justice". Dhe ky projekt, dhe ky shkëmbim informacioni është bërë në kuadër të këtij projekti. Pra, nuk ka as marrëveshje të ILD-së për të çuar lart e poshtë të dhëna, apo për të marrë konfirmime nga të tjerë, duke anashkaluar konfirmimin e institucioneve shqiptare. E thashë si argument profesional. E dyta, në asnjë rast nuk bëra teori, fola standard. Kur keni qenë ju gjyqtar, ka qenë tjetër situatë dhe tani është tjetër situatë. Dhe raporti që duhet të bëjë ILD-ja është të masë ngarkesën e punës që kanë gjyqtarët, jo për faj të tyre vetëm, me neglizhencën. Dhe këtë po bëjmë. Kemi dërguar magjistratë për shkarkim në Këshillat dhe Këshillat nuk e kanë gjetur të drejtë propozimin e bërë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Dhe mendoj se këtu duhet të bëjmë diskutim. (Ndërhyrje pa mikrofon) Një sekondë, s'ka një sekondë, të lutem, të mbaroj. Në raport me shkeljen e etikës, që ndodh në mbledhjen e KLP-së, që ka ndodhur një herë në atë që kam parë në media, çdo çështje që ndodh brenda juridiksionit, apo brenda kompetencave që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, e ndjekim me vëmendje. Dhe natyrisht ndërhyjmë atëherë kur vlerësojmë që është roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të ndërhyjë në punën e një organi tjetër kushtetues, edhe për çështjen e etikës. Natyrisht, në parantezë duhet thënë këtu, që nuk ka pasur asnjë ankesë nga asnjë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për çështje që i takojnë çështjeve të etikës në Këshill.

Dhe unë mendoj që përgjegjshmëria fillon këtu më së pari, por kjo është çështje individuale është personale. Dhe kjo çështje e diskrecionit tek e fundit. Pas konsultimit me inspektorët, në mbledhjen e përgjithshme të inspektorëve, sipas ligjit, kemi vlerësuar kur duhet ndërhyrë dhe ku s'duhet ndërhyrë. Kemi ndërhyrë në shkelje etike në një rast të një anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe e kemi dërguar për masë disiplinore pranë organit përgjegjës, dhe po presim përgjigje për ecjen e sigurimit të procedurës. Kjo ishte.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Faleminderit. Pyetje të tjera? Ka pyetje të tjera nga kolegët? Ok, kam unë disa pyetje. Pyetja e parë është: Sa nga inspektimet dhe procedimet disiplinore të iniciuara prej jush reflektojnë gjetjet e vendimmarrjeve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut për vendimmarrjen e shkelje të hapur të ligjit, ose për paaftësi profesionale të prokurorëve dhe gjyqtarëve? Disa shembuj kanë arritur të bëhen publike edhe në media, dhe që janë shkelje flagrante. Ka një vendimmarrje përfundimtare për to? Sa kanë shërbyer këto si indicie për inspektimet tuaja? Keni shembuj konkretë? Gjithashtu, ka disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, dhe disa vendime të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, apo edhe përfshirë këtu, po deshtë, ju dhe udhëzimet e përgjithshme që nuk zbatohen nga prokurorët apo nga gjyqtarët, dhe vendimet e tyre prishen në mënyrë të përsëritur për këtë shkak, që është jo thjesht një keqkuptim dhe vetëm i pavarësisë së prokurorëve dhe gjyqtarëve, por keqzbatim i ligjit, me apo pa qëllim, natyrisht edhe paaftësi të dukshme profesionale. Disa shembuj të kësaj natyre i solli këtu sot edhe prokurori i përgjithshëm në parashtresën e tij. Tjetra që kam lidhet me efikasitetin dhe cilësinë e vendimmarrjes së ILD-së. Sa përqind zënë inspektorët dhe ndihmësinsektorët që merren drejtpërdrejt me inspektimin në strukturën organike tuaj? Meqenëse ju kam parë që keni bërë edhe një vështrim historik të inspektimit në Shqipëri, sa është i krahasueshëm kjo me Inspektoriatin që ka pasur Ministria e Drejtësisë? Dhe në këndvështrimin tim, ju keni staf disa herë më shumë se ç'kanë patur ato, por pyetja ime është: si është numri i masave disiplinore, po në raport me të kaluarën? Cila është ajo çfarë ka sjellë ndryshim Inspektori i Lartë i Drejtësisë në raport me strukturat paraardhëse? Sepse Inspektori është e vërtetë që është një strukturë tërësisht e re nga pikëpamja e pozicionit kushtetues, por veprimtaria inspektuese nuk është e re në Shqipëri. Nuk fillon vit... nuk ka vit zero në këtë rast. Atëherë mund të na lejojë të bëjmë një krahasim, besoj unë. Sa inspektorë kemi pasur, sa njerëz kemi pasur ne që e bënë këtë punë dikur në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sa masa disiplinore dhe sa gjyqtarë i janë nënshtruar masave disiplinore dhe vendimmarrjeve, dhe sa sot, që kemi 5 herë më shumë, 6 herë më shumë ndoshta inspektorë se ç'kanë pasur ato, të marra së bashku, në një perceptim, ose ndoshta në një mungesë informacioni. Ndoshta mund të ketë ndonjë mungesë informacioni, por ashtu siç e shoh unë këtë gjë. Tjetra: cili është efekti që kanë pasur inspektimet tuaja në çështjen, në kohëzgjatjen e hetimeve dhe gjykimeve, dhe sidomos në zbardhjen në kohë të vendimeve gjyqësore? Pra, unë dua të di, si ligjvënës, si përfaqësues i zgjedhësve të mi, cili është efekti i kësaj, i këtij institucioni kushtetues, mbi këtë problematikë që shqetëson sot qytetarët, që ka të bëjë me kohëzgjatjen e hetimeve dhe gjykimeve tej afateve ligjore, dhe sidomos edhe me zbardhjen në kohë të vendimeve gjyqësore që tejkalojnë shumë herë çdo lloj afati të mundshëm ligjor?

*Cili është efekti? Si e masni ju këtë? Keni ju një indikator matës? Dhe a mund të na thoni, për shembull, për vitin 2025, 2024, cili është ky efekt, që ta kuptojmë? Tjetra që kam unë: cila është gjeografia e inspektimeve tematike edhe gjatë vitit 2025? Ku jeni të shtrirë ju? Jeni të shtrirë në Tiranë, në Apel, apo në gjykata dhe prokurori periferike? Tjetër: ju thatë lidhur me plotësimin e vakancave, thirrje ka, aplikime nuk ka, ndërkohë që bëhet... Bashkimi Europian mbi bazën edhe të këtij shqetësimi real, por edhe të ankesave tuaja të përsëritura, vazhdon ta konsiderojë këtë një nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore. Ndërkohë që edhe vetë procesi i inspektimit e ka nevojë jetike. Cila është zgjidhja, sipas jush? Është çështje ligji? Është çështje se gjyqtarët dhe prokurorët nuk e shohin, nuk e fillojnë karrierën e tyre me zyrën e inspektorit, apo ka nevojë që të... për të marrë, për të vendosur disa kritere që, pa cënuar kriteret e cilësinë e përfaqësimit të tyre? Për shembull, fjala vjen, unë e trajtova edhe me prokurorin e përgjithshëm. Ne kemi shumë gjyqtarë dhe prokurorë sot që janë në moshë pensioni, ose që e kanë kaluar atë, që janë shumë të aftë fizikisht dhe mendërisht, të cilët edhe për shkak të përvojës do të ishin një kontribut shumë i mirë nëse ata do të ishin, qoftë dhe këshilltarë pranë inspektorit. Do t'u jepej mundësia të bënin dhe pensionin dhe të merrnin dhe një kontribut shtesë si inspektorë. Përvoja ua lejon, qoftë edhe me kontrata njëvjeçare, për shkak të gjendjes fizike, për të ndjekur dhe për ta plotësuar këtë vakancë. Edhe, besoj unë, do ta bënte edhe më të... edhe nga pikëpamja e cilësisë do ta ndihmonte, do ta ndihmonte institucionin tuaj. Ky është këndvështrimi. Tjetër që kam: cili është niveli i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe specifikisht të inteligjencës artificiale në trajtimin, në mbledhjen e ankesave, trajtimin e ankesave, krijimin e dosjes rreth ankesave dhe gjurmueshmërinë e zbatimit të tyre? Personalisht, kam pasur rast të shoh nga disa djem dhe vajza të rinj, disa aplikime që lidhen me drejtësinë, dhe kam bindjen që 70-80% të asaj pune që bëni ju, nëse teknologjia e informacionit do të hynte më gjerësisht, do ta shkurtonte dhe nuk do të kishte nevojë fare për inspektorë, sepse do ta merrte automatikisht përgjigjen për ato shkaqe, të paktën, që përmendët ju, që janë shkaqe ligjërish të kapshme, sidomos nga intelijenca artificiale. Dhe në fund, kam edhe dy pyetje të tjera konkrete. Sa është kohëzgjatja mesatare e hetimeve disiplinore të përfunduara dhe atyre në proces? Keni ju një njësi matëse për këtë gjë? Sepse shikoj, janë vetëm 12 vendime për fillimin e hetimit disiplinor të 2025, ndaj për 9 procedurat kanë mbetur në proces në fund të vitit, janë mbartur. Dhe tjetra: sa është koha mesatare nga paraqitja e kërkesës së ILD-së deri në vendimmarrjen e Këshillave? Kur vendimmarrja e Këshillave ndryshon nga kërkesa juaj, cilat janë arsyt kryesore? Është standardi i provës? Është cilësimi ligjor i shkëlqes? Është proporcionaliteti i masës? Apo çështje procedurale që përbëjnë shkak për një qëndrim të ndryshëm? Dhe në fund, kam një pyetje që më duket është pyetje... është herët, konceptualisht herët, por është një nga dilemat e mia si ligjvënës. Është zgjidhje e drejtë ndërtimi i Inspektorit si një organ monokratik, apo ka nevojë që të ishte një organ kolegjal? Faleminderit.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po, faleminderit për pyetjet, kryetar. Po filloj nga këto që fiksova të fundit. Së pari, në lidhje me afatet e hetimeve disiplinore: ligji parashikon që afati për kryerjen e hetimit është 6 muaj, por për shkak të ngarkesës së kompleksitetit të çështjeve, mund të shtyhet edhe 3 muaj. Pra, afati maksimal është 9 muaj. Ato shifra që përmendëm janë procedura hetimi që mund të kenë filluar, po them në tetor, që janë përfunduar, apo janë duke u përfunduar tani. Në asnjë rast nuk ka asnjë kalim afati të hetimit disiplinor, se përndryshe do binte.

Nuk ka të jetë parashkruar ndonjë rast në dorë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkak të kalimit të afatit brenda zyrës së ILD-së. Në lidhje me pyetjen e dytë, që ndoshta do të... pyetjen e fundit që bëtë ju, është një pyetje shumë interesante, në fakt, e mendoj dhe vetë. Edhe, po është siç thatë ju, është herët për të dhënë një përgjigje, sepse ka nevojë të bësh një balancë shumë të rëndësishme, edhe me natyrën e institucionit, natyrën e balancave që duhet të ruajë, natyrën e të qenit në një ambient me shumë sfida, edhe për shkak të problematikës në të cilën është sistemi i drejtësisë, por edhe për shkak të problematikave që ka shoqëria sot. Dhe do padyshim, një qëndrueshmëri shumë të fortë bazuar në standarde dhe jo në emocione të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në këndvështrimin tim. Po siç thatë dhe ju, është herët, dhe ndoshta kjo mund të jetë pjesë e një diskutimi që unë do të doja ta vazhdoja në një moment të dytë. Në lidhje me pyetjen... me nivelin e përdorimit të IA-së: pa dyshim bie dakord me ju që zhvillimi i teknologjisë... pa dyshim, duhet të jetë pjesë e reflektuar në veprimtarinë e institucioneve tona, veçanërisht në zyra, që siç thatë ju, mund të jenë gjëra më të thjeshta për t'u evidentuar nga intelijenca artificiale. Ne, edhe në zbatim të rekomandimit të Kuvendit, por edhe të zhvillimit strategjik të institucionit, e kemi përfshirë edhe teknologjinë e inteligjencës artificiale, edhe në projektin e ri që po bëjmë. Pra, do të hidhet në prokurim publik projekti që kemi hartuar në lidhje me digjitalizimin e çdo procesi pune në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Natyrisht, edhe përdorimin e inteligjencës artificiale brenda atyre kufijve që ndoshta na lejon dhe ligji, sepse pa dyshim është një sfidë e re edhe në kuptimin ligjor të gjësë. Me informacionet që kam, ka edhe magjistratë jashtë Shqipërisë të shkarkuar për përdorimin e inteligjencës artificiale, tej atyre parashikimeve që parashikon ligji. Pra, është një sfidë që ka nevojë të adresohet çdo ditë, edhe me kuadrin ligjor që kemi. Por gjithsesi, është pjesë e projektit, të cilin ne do e prokurojmë tani së shpejti. Në lidhje me gjeografinë e inspektimeve tematike: unë nuk di të kemi ndonjë gjykatë ose prokurori të Shqipërisë që nuk e kemi prekur në inspektim. Me thënë të drejtën, jam i bindur 99%, sepse çdo vit mundohemi ta prekim çdo gjykatë apo çdo prokurori të vendit, për të bërë Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë prezent në çdo gjykatë dhe prokurori, natyrisht me tematika të ndryshme, sepse s'mund t'i bëjmë të gjitha gjykatat dhe prokurorit me një tematikë të caktuar. Kështu që kjo është përgjigja për këtë. Është e gjerë gjeografia e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në gjykatë dhe prokurori.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Këtu, më fal, ndjesë, do të ndërhyj. Për shembull, keni ju inspektime tematike në Apel të Tiranës, në Apelin Administrativ, në Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Në dy vitet e fundit?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Tani, me vite s'e di, por në Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë kemi qenë për zvarritjen e proceseve dhe zbardhjen me vonesë të vendimeve gjyqësore. Në Apelin e Tiranës filluam këtë vit. Në Apelin Administrativ, ta konfirmoj...

Në Apelin Administrativ nuk kemi. Po mund të jetë pjesë e një diskutimi, sepse nuk na ka dalë problematika nga ankesat, as nga rekomandimet që na kanë përcjellë institucionet. Pra, si me thënë është dinamikë edhe përzgjedhja e tematikës së inspektimit. Lidhur me mosplotësimin e vakancave... është një gjë që është shumë komplekse. Plotësimi i vakancave me magjistratë, kryesisht gjyqtarë. Unë thellësisht mendoj që ajo zyrë ka nevojë për inspektorë gjyqtarë, për shkak të formimit të tyre profesional, edhe prodhimi i materialit apo sfidat me të cilat ata hasin çdo ditë, do i bënte mirë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që në atë pozicion, gjyqtarët të adresonin jo vetëm pyetje, por edhe zgjidhje që mund t'i lehtësojnë ata dhe kolegët e tyre në punën e tyre si gjyqtarë, apo të evidentojnë edhe probleme. Fakti që nuk paraqiten gjyqtarë lidhet me shumë faktorë, nga vakancat në sistem, apo se ndoshta janë më të interesuar që profesionalisht ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, nëse plotësojnë kriteret. Përgjithësisht, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë historikisht është parë si një zyrë ku do trajtosh punën e kolegëve, dhe jo të gjithë e kanë një kënaqësi këtë. Por mendoj që sfida dhe arritja më e madhe që ka pasur Inspektori në raport me këtë çështje, ka qenë dhënia e besimit të magjistratëve, që ky institucion nuk është një institucion shantazhi, apo një institucion që keqpërdoret për arsye personale, apo për arsye të tjera jashtë atyre që ka parashikuar Kushtetuta dhe ligji. Pikërisht për t'i dhënë besim atyre, që nëse do vinin si inspektorë, do të bënin punën sipas parashikimeve ligjore dhe jo sipas emocioneve jashtë apo brenda institucionit. Natyrisht, kjo lidhet edhe me çështje të tjera ndoshta, që nuk mund t'i adresojmë këtu, por gjithsesi fakti është ky: që nuk ka gjyqtarë që të aplikojnë për pozicionin e inspektorit. E kundërta ndodh për prokurorët. Ka shumë kërkesa nga prokurorët, që duan të vijjnë...po ka kërkesa nga prokurorët për të ardhur në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si inspektorë. Edhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kemi pasur një debat për një kohë të gjatë me njëri-tjetrin, nëse ata do vazhdonin të plotësonin vakancat e Inspektorit të Drejtësisë me inspektorë, sepse pa dyshim sistemi i prokurorisë ka nevojë edhe për prokurorë, jo vetëm për inspektorë. Kështu që në këtë diskutim sot zyra ka 5 inspektorë dhe unë jam shumë i kënaqur me punën e magjistratëve, inspektorëve prokurorë, sepse me kalimin e kohës ata realizojnë edhe më shumë inspektime tematike, më shumë rekomandime për sistemin, edhe brenda sistemit të prokurorisë. Pra, si me thënë, është një eksperiencë pune që atyre u ka shërbyer dhe fakti që kanë kërkuar që të vazhdojnë komandimin për një mandat të dytë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është një vlerësim edhe për punën, por natyrisht edhe për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mungesën e inspektorëve gjyqtarë jam munduar ta kompensoj me marrjen e dy magjistratëve gjyqtarë pranë kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sot kemi dy gjyqtarë këshilltarë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët janë pjesë e rëndësishme e ndihmës, apo e punës që bëhet në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sa i përket organikës, sot kemi 10 inspektorë dhe 23 ndihmës-inspektorë, që bëjnë 33, përfshirë edhe drejtorinë juridike, që duhet të jenë 6 ose 7 juristë që punojnë pranë drejtorisë juridike. Pra, rreth 40 individë në zyrën e Inspektoratit të Drejtësisë merren me çështjet e inspektimit, ndjekjen e rekomandimeve, aktet juridike që nxjerr Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me çdo....

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Rreth 40 që i shërbejnë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Rreth 40 që i shërbejnë qëllimit...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** 35%?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Rreth 40 individë. Padyshim pjesa tjetër është pjesë e detyrimeve që ka institucioni, si institucion publik. Ka zyrë finance, ka zyrë prokurimi publik, ka zyrë shërbimesh, e kështu me radhë. Por gjithsesi struktura ka kaluar dy apo tre herë, edhe pranë komisioneve përkatëse në Kuvend dhe është miratuar edhe nga Kuvendi me analizën përkatëse. Në lidhje me atë punë që është bërë përpara nga inspektoratet e mëparshme, unë mendoj që është e vështirë që të krahasohen, edhe për shkak të natyrës së punës, edhe për shkak të ngarkesës së punës, edhe për shkak të gjendjes në të cilën është sistemi sot. Ndryshe ka qenë sistemi më përpara, ndryshe i ka sfidat sot, në këndvështrimin tim. Kështu që është e vështirë të bëhet një krahasim. Unë nuk e di se sa inspektime janë kryer nga Ministrinë e Drejtësisë më parë, nuk e kam këtë të dhënë. Ajo ku jam fokusuar bashkë me inspektorët është që të realizoj detyrën që kam, në përputhje me ligjet dhe në përputhje me Kushtetutën. Natyrisht, emocionet dhe sfidat me të cilat përballet sistemi mund të jenë të shumta, por unë mendoj, që ajo me të cilën ne duhet të biem dakord është që këto janë sfida me të cilat nuk zgjidhen, ose të cilat nuk zgjidhen vetëm nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Është një gjë shumë komplekse. E theksoj edhe një herë: nuk ka asnjë rast në tavolinën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, asnjë magjistrat, prokuror apo gjyqtar, që ta ketë merituar për të qenë pjesë e procedimit disiplinor dhe të mos jetë bërë pjesë e procedimit disiplinor. Dhe këto nuk janë gjetje të mia, por janë ankesa që janë verifikuar edhe nga ata që monitorojnë punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Efekti i inspektimeve për kohëzgjatjen e vonesave. Në fakt, është një çështje shumë e drejtë, me thënë të drejtën. Ne mundohemi ta balancojmë edhe me ngarkesën që kemi, edhe me numrin e inspektorëve që kemi, sepse të matësh efikasitetin e rekomandimeve, të cilat ti ke lënë, ka nevojë të bësh një inspektim të dytë, apo një proces të dytë verifikimi të atyre gjërave që janë gjetur apo janë rekomanduar. Dhe natyrisht, kjo do kohë, do edhe burime njerëzore, do edhe metodologji, të cilën jemi duke e zhvilluar edhe në përputhje me partnerët ndërkombëtarë. Këtë vit kemi parashikuar dy inspektime vijuese, për të matur dy inspektime tematike, të cilat ne i kemi kryer kohë më parë, dhe të shohim se, e para, të kuptojmë vetë se si mund të kryhen më shpejt ose më mirë këto lloj inspektime vijuese, dhe natyrisht të dalim me një metodologji që mund të na shkurtojë edhe kohë, por edhe ndoshta procese pune, që nuk kanë nevojë të jenë të gjata, ndoshta nëpërmjet një inspektimi tematik. Së dyti, matja e efikasitetit të rekomandimeve, mendoj unë, varet nga shumë faktorë.

Së pari, lidhet me reformat, ose reformat e sistemit të drejtësisë janë procese afatgjata, të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për t'u implementuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Së dyti, procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga ILD kërkon kohë, se edhe efektiviteti i tyre varet edhe nga rekomandimet e zbatuara nga institucionet e tjera, pra nga bashkëveprimi i institucioneve të tjera, siç janë Këshillat, Prokurori i Përgjithshëm, Shkolla e Magjistraturës, gjykatat, prokuroritë, administratat dhe gjykatat e prokurorisë, e me radhë. Së treti, është thelbësore, mendoj, nevoja për një qasje të koordinuar dhe bashkëpunim ndërinstitucional, edhe nëpërmjet Këshillave, Prokurorit të Përgjithshëm, ILD-së, që në identifikim të problematikave që ka nevojë sistemi, për t'u adresuar nëpërmjet inspektimit tematik dhe institucional, që është po aq i rëndësishëm sa inspektimi tematik. Së katërti, sistem drejtësie, i cili ka sfida të mëdha, që nga infrastruktura dhe çështjet e sigurisë,

është e vështirë që të masësh efikasitetin e rekomandimit të ILD-së në një sfidë shumë më të madhe, sa i përket punës që duhet të bëjnë gjyqtarët dhe kushtet në të cilat duhet ta bëjnë këtë punë. Prandaj them, është një proces kompleks, proces i vështirë dhe proces i gjatë, matja e efikasitetit të organit, në këtë rast Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Por në çdo rast, ne jemi duke e verifikuar dhe duke marrë masa, që çdo rekomandim i dhënë të gjurmohet në radhë të parë, e të kuptojmë pse nuk është zbatuar, në rastet kur nuk është zbatuar, apo si është zbatuar në rastet kur është zbatuar. Po, një pyetje shumë e rëndësishme, mendoj unë është: sa janë reflektuar gjetjet nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, apo Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në inspektimet e kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë? Raporti me Gjykatën e Lartë është shumë profesional, mendoj unë, sepse në çdo rast Gjykata e Lartë e ka vënë në dijeni Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në ato raste kur ka hasur, apo kur ka evidentuar kalime të afatit të arsyeshëm për zbatim të procesit gjyqësor, apo zbardhjes së vendimeve, ne i kemi verifikuar, pra janë procese verifikimi. Në ato raste kur kemi vlerësuar që mund të jenë pjesë e hetimit disiplinor, kemi vepruar. Në ato raste kur kemi menduar që ka qenë një afat i balancuar me ngarkesën që ata kanë, dhe nuk janë shfaqur raste neglizhence nga ana e magistratit për kalimin e afatit të procesit, apo zbardhjes së vendimit gjyqësor, kemi vijuar me arkivimin e rastit.

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Ka patur rast kur gjykata i ka thënë që ke zbatuar keq ligjin, haptazi, ke shkelur ligjin.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Qartë, pra. Një rast e kemi në dorë, për shembull, një rast të tillë. Pra, është një dinamikë raportimesh, edhe me ato vendime që na vijnë nga Gjykata e Lartë, ose edhe vetë ato që shohim. Kemi pasur raste procedimesh magistrati, kur ka pasur vendimmarrjen, rasti i parë ka qenë i tillë. Ka pasur raste gjyqtarësh që kanë qenë në kundërshtim me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, për shembull. Pra, edhe një rast që e kemi tani, një magistrat, që do iki me procedim disiplinor, pikërisht për këtë shkak do ikë, pasi vendimmarrja e tij ka qenë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Lartë, në raport me çështjen që ka trajtuar. Pra, si me thënë, është dinamikë. Unë nuk di të them sa raste tani, por në çdo rast është një proces që ne e ndjekim me rigozitet, në çdo fazë të punës në të cilën jemi. Edhe vendimet e GJEDNJ i ndjekim me vëmendje, në ato raste, që sipas mendimit tonë duhet dhe justifikojnë ndërhyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Por ne natyrisht e vlerësojmë këtë me atë detyrim që kemi, në raport edhe me paqartësitë që shfaq vetë sistemi.

Kështu që është një proces që ne e konsultojmë fort, edhe natyrisht të gjitha këto që thatë, mund të jenë pjesë e një diskutimi tjetër, që ne do bëjmë me mbledhjen e përgjithshme të inspektorëve, por kjo është përgjigjja ime për këtë pyetje.

Në lidhje me udhëzimin, apo udhëzimet e përgjithshme që nxjerr Prokurori i Përgjithshëm, kemi pasur dy raste procedimi prokurorësh. Në dy rastet, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur ta rrëzojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Dhe ta lidh me pyetjen tjetër që bëtë: në të gjitha rastet kur janë rrëzuar propozimet që ka bërë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk është rrëzuar për shkak të mangësive në hetim, apo hetimit të paplotë, apo hetimit jo profesional, apo jo procedural, por ka qenë thjesht çështje proporcionaliteti, apo diskrecioni i Këshillit në raport me masën, kryesisht me masën. Madje, edhe sot që flasim, ka një rast të tillë që presim vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në lidhje me një rast magistrati. Këto pyetje, besoj ishin sic i kemi shënuar. Ndjesë nëse i jam shmangur diku...

**Kryetari i Komisionit Fatmir Xhafaj:** Nuk është shmangie e qëllimshme, besoj stafi, Dëshira, ua ka mbajtur mirë shënim, kështu që... Ok. Kemi ndonjë gjë tjetër nga kolegët? Ok, mirë. E mbyllim këtu atëherë. Besoj se ishte një diskutim i dobishëm, në funksion të qëllimit të kësaj seance dëgjimore që ka të bëjë me zbatimin e rezolutës së vitit 2025 dhe rekomandimeve për vitin 2026. Ne do t'i votojmë në parim, vetëm në parim, zoti Hasalla, rekomandimet. Do t'i japim kohën e nevojshme për të reflektuar dhe mbi bazën e këtij diskutimi që u bë këtu, edhe objeksionet, kontestet, por edhe natyrisht edhe për t'i dakordësuar, për aq sa mundemi, dhe biem dakord edhe me opozitën, që për arsye objektive një pjesë e saj nuk është sot këtu, për shkak të një angazhimi tjetër ndërkombëtar. Kështu që do t'i votojmë në parim, edhe për të lënë në një moment të dytë të reflektojmë objeksionet. Kush është dakord në parim? Kundra- s'ka! Abstenim-s'ka dakord? E mbyllim këtu këtë mbledhje të komisionit. Faleminderit, zoti Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Faleminderit, zonja Zëvendësinspektore dhe Sekretare e Përgjithshme. Ditë të mbarë të gjithëve.



## DIALOG I NIVELIT TË LARTË NË ILD MBI PËRGJEGJSHMËRINË GJYQËSORE DHE STANDARDET E INSPEKTIMIT



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, mirëpriti Prokurorin e Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë të Holandës, z. Edwin Bleichrodt, i cili shoqërohej nga Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, z. Reinout Vos, znj. Anne Tahapary nga Qendra e Trajnimit dhe Studimeve për Gjyqësorin e Holandës (SSR), si dhe znj. Edlira Osmani, Këshilltare e Lartë e Politikave për Sundimin e Ligjit në Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri.

Pjesë e vizitës ishte zhvillimi i Dialogut të Nivelit të Lartë ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë të Holandës, z. Edwin Bleichrodt, dhe Njesisë së Inspektorëve dhe Ndihmësinsektorëve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), me temë “Përgjegjshmëria Gjyqësore dhe Standardet e Inspektimit”. Gjatë këtij dialogu u diskutuan gjerësisht përvoja holandeze dhe ajo shqiptare në fushën e inspektimit të sistemit të drejtësisë, si dhe u shkëmbyen praktika dhe qasje mbi standardet profesionale dhe mekanizmat e përgjegjshmërisë gjyqësore.

Objekti i këtij dialogu strategjik ishte nxitja e shkëmbimit institucional ndërmjet Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë të Holandës mbi përgjegjshmërinë gjyqësore, metodologjitë e inspektimit dhe sfidat sistematike të drejtësisë. Vëmendje e veçantë iu kushtua balancimit të pavarësisë së gjyqësorit me mbikëqyrjen efektive, përmirësimin të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë,

si dhe forcimit të besimit të publikut përmes praktikave të inspektimit transparente dhe të bazuara në analizën e riskut, në përputhje me standardet evropiane të shtetit të së drejtës.

Prokurori i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë të Holandës, z. Edwin Bleichrodt, duke u mbështetur në përvojën e tij në drejtimin e një strukture prej 22 avokatësh të përgjithshëm, e cila ushtron kompetenca në fushën e mbikëqyrjes dhe procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, prezantoi modele konkrete pune dhe praktika institucionale. Në fjalën e tij, ai u ndal te përgjegjshmëria gjyqësore si një element plotësues i pavarësisë së gjyqësorit, si dhe te standardet e Bashkimit Evropian për shtetin e së drejtës. Gjithashtu, ai trajtoi rëndësinë e identifikimit të problematikave sistematike, përtej përgjegjësisë individuale të magistratëve, si një qasje që kontribuon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë.

Gjatë diskutimeve u evidentuan ngjashmëri mes praktikës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe modelit holandez, veçanërisht në lidhje me mënyrën e planifikimit dhe përcaktimit të inspektimeve, të cilat bazohen në problematikat e evidentuara nga ankesat e paraqitura dhe në analizën e riskut.

Takimi u organizua në kuadër të projektit MATRA të Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, pjesë e projektit “Forcimi i Integritetit Gjyqësor”, i cili zbatohet nga Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin.











## FJALA E ILD NË TAKIMIN E INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË



*“Mbi zbatimin e strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030: Arritjet dhe sfidat në vijim për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të integritetit evropian”*

*I nderuar z. Ministër,*

*Të nderuar partnerë ndërkombëtarë,*

*Të nderuar drejtues të institucioneve të sistemit të drejtësisë,*

Faleminderit për ftesën, e cila tregon se sa i rëndësishëm është bashkëpunimi mes institucioneve të drejtësisë dhe degëve të tjera të pushtetit, bashkëpunim i cili duhet të jetë një normalitet dhe duhet të jetë një mënyrë të qenë, e jo takime sporadike apo shkak të angazhimeve të caktuara. Takimi i sotëm përfaqëson më shumë sesa një moment raportimi mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030. Ai është një mundësi për të reflektuar mbi mënyrën se si institucionet tona bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, si i matin rezultatet e reformave dhe si ndërtojnë mekanizma të cilat ti shërbejnë rritjes së cilësisë së drejtësisë, forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmbushjes së angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Sot reforma në drejtësi ka hyrë në një fazë të re, ajo kërkon institucione që jo vetëm ushtrojnë kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore por institucione të cilat detektojnë, analizojnë dhe adresojnë problematikat sistemike të sistemit të drejtësisë.

Nga raporti vjetor i monitorimit rezulton se gjatë vitit 2025 janë shënuar zhvillime të rëndësishme në të pesë shtyllat e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. qëllimi i dytë dhe i tretë politik i SND-së që lidhet me forcimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë dhe rritjen e cilësisë së drejtësisë, pavarësisht sfidave të evidentuara vit pas viti me vakancat,

arritje të rëndësishme janë shënuar, përmend këtu rritje të numrit të ankesave të shqyrtuara, por edhe rritje të numrit të inspektimeve, tematikave dhe rrjedhimisht rekomandimeve. Vit pas viti, ILD jo vetëm ka treguar rritje të qëndrueshme të performancës, por edhe cilësinë përmes nxjerrjes së rekomandimeve dhe matjes së rezultatit të tyre, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së punës në gjykata dhe prokurori.

Përvoja mbi 6 vjeçare e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka treguar se sfidat më të rëndësishme nuk lidhen vetëm me rastet e përgjegjësisë individuale të magjistratëve nëpërmjet procedimeve disiplinore, por me detektimin e problematikave sistemike që pengojnë funksionimin normal të sistemit të drejtësisë, analizimin e tyre dhe dhënia e kontributit real dhe konkret në përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe kulturës së integritetit.

Një sistem drejtësie nuk përmirësohet vetëm duke ndëshkuar.

Ai konsolidohet atëherë kur ndërtohen instrumentet e nevojshëm për t'i parandaluar ato.

Sfidat me të cilat po përballlet sistemi i drejtësisë aktualisht nuk janë individuale apo përgjegjësi e një apo e disa institucioneve. Shumë prej tyre janë problematika të nivelit sistematik, të lidhura me organizimin institucional, strukturor, ngarkesën e sistemit, vakancat, apo nevojën për iniciativa ligjore. Për këtë arsye, edhe qasja jonë duhet të evoluojë. Nga analizimi i gjetja e përgjegjësisë individuale duhet të kalojmë drejt analizimit të fenomeneve, shkaqet nga të cilat këto problematika kanë ardhur dhe si t'i adresojmë ato. Nga fryma e ndëshkimit duhet të kalojmë tek ajo e parandalimit dhe e përmirësimit të cilësisë së drejtësisë, pasi kjo është ajo që qytetarët presin nga ne sot, ajo për të cilën u ndërmor reforma në sistemin e drejtësisë përpara 10 viteve.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Rruga drejt një sistemi drejtësie efikas dhe të qëndrueshëm kërkon bashkërendim institucional, transparencë dhe respekt të parimit të ndarjes së pushteteve. Vetëm përmes bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët, mund të garantojmë një sistem drejtësie që i shërben qytetarit dhe që mund të funksionojë mbi themele të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe besueshmëri.

Asnjë institucion nuk mund t'i zgjidhë i vetëm problematikat sistemike të drejtësisë. Kompetencat ushtrohen në mënyrë individuale por përgjegjësia për ndërtimin e një sistemi drejtësie funksional, efektiv dhe që i përgjigjet pritshmërive të publikut është e të gjithëve ne. Nëse rruga drejt përfundimit të negociatave me BE, jo vetëm si një proces teknik por edhe si proces vlerash rezultojnë të suksesshme, edhe sistemi i drejtësisë ka pjesën e vet të meritës në këtë rrugëtim. Por njëlojë e vërtetë është se nëse ky proces dështon, pjesë e përgjegjshmërisë do jetë edhe sistemi i drejtësisë. Prandaj bashkëpunimi ndërinstitucional nuk duhet parë vetëm si një detyrim për t'u përmbushur mbështetur në rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë apo realizimin e objektivave të strategjisë. Bashkërendimi i veprimtarisë së institucioneve tona duhet të perceptohet dhe të zhvillohet si një instrument i domosdoshëm për të konsoliduar standardet e një drejtësie të pavarur, eficiente dhe të shpejtë që i përgjigjet nevojave të publikut për të marrë drejtësi në një kohë të arsyeshme.

Sot kemi nevojë për institucione që jo vetëm reagojnë ndaj problematikave, por që janë në gjendje t'i parashikojnë ato; institucione analizojnë fenomene dhe rekomandojnë zgjidhje; institucione që jo vetëm raportojnë statistika, por i përdorin ato për të përmirësuar vendimmarrjen sepse cilësia e sistemit të drejtësisë nuk përcaktohet vetëm nga vendimet që ai merr, por edhe nga aftësia për të mësuar nga përvoja, për të korrigjuar dobësitë dhe për të ndërtuar standarde gjithnjë e më të larta të integritetit dhe përgjegjshmërisë.

Jam i bindur se Mekanizmi i ri i Bashkëpunimit Ndërinstitucional për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe Barometri i Drejtësisë do të kontribuojnë në ndërtimin e një kulture të re bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë, të bazuar në koordinim, transparencë dhe bashkërendim ndërinstitucional. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ofruar angazhimin dhe kontributin e tij maksimal, pasi personalisht vlerësoj se vetëm atëherë kur do të arrijmë të krijojmë një frymë dhe kulturë të bashkëpunimit të qëndrueshëm institucional pa u kufizuar në evidentimin e të dhënave sasiore por duke adresuar fenomene që na prekin të gjithëve do të mund të përmbushim standardet që kërkon procesi i integritetit evropian dhe çfarë është më e rëndësishme atë publiku pret nga ne dhe nga reforma, një drejtësi më cilësore, më efikase, më të besueshme dhe më të shpejtë.

Ju faleminderit!



## KORRIKU I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit korrik 2026 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **113 ankesa**, nga të cilat, **111 të depozituara** nga qytetarë dhe **2 ankesa** nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit korrik 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

| ARKIVIME                                                                                                                                                                                                            | VERIFIKIME                          | PROCESI DISIPLINOR                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>128 vendime</b> nga 269 praktika të trajtuara:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>97 vendime</b> arkivimi pas shqyrtimit fillestar</li><li>- <b>31 vendime</b> arkivimi pas verifikimit</li></ul> | <p><b>43 vendime</b> verifikimi</p> | <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>1 vendim për fillim hetimi disiplinor</b> për 1 magjistrat (prokuror)</li><li>- <b>2 vendime për përfundim hetimi disiplinor</b> për 2 magjistrate (një gjyqtarë, një prokurorë)</li><li>- <b>1 vendim pezullim hetimi disiplinor</b> për 1 magjistratë (gjyqtarë)</li><li>- <b>3 kërkesa për procedim disiplinor</b> për 3 magjistratë (2 gjyqtarë, 1 prokurorë)</li></ul> |

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në **info@ild.al** ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD **www.ild.al**, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

## KLP PRANON KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ PROKURORES A.K.



Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), në seancën e zhvilluar sot, pranoi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates A.K., prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Masa u kërkuar nga ILD për shkelje të dispozitave që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, si edhe për shkelje të rregullave të konfidencialitetit dhe ndalimit të përhapjes së informacionit që lidhet me një hetim në zhvillim ose të përfunduar.

Ky procedim erdhi pas rishqyrtimit të vendimit të mëparshëm të KLP-së, të datës 2 tetor 2025, me të cilin ishte rrëzuar kërkesa e ILD-së për caktim masë disiplinore ndaj prokurores. Pas ankimit të ILD-së, Gjykata Administrative e Apelit pranoi padinë, duke i lënë detyrë KLP-së të shqyrtojë sërish kërkesën për procedimin disiplinor.

Sipas raportit hetimor të ILD-së, prokurorja A.K. ka nënshkruar shkresa pa pasur kompetencën përkatëse,

si dhe ka nxjerrë e u ka dërguar personave të tretë kopje të akteve, që ishin pjesë e dosjes së një çështjeje ende në hetim.

Sipas ILD-së, këto veprime kanë anashkaluar autoritetin e drejtuesit të prokurorisë, kanë cenuar imazhin institucional të organit të akuzës dhe kanë krijuar rrezik për mbarëvajtjen e hetimit. Gjithashtu, publikimi i akteve procedurale, vërehet në raportin hetimor të ILD-së ndaj A.K., mund të ndikojë negativisht në besimin e publikut, pasi prokuroria vepron në përputhje me ligjin dhe jo mbi bazën e vullnetit individual të magjistratit.

Gjatë rishqyrtimit të çështjes, ILD i kërkoi sërish KLP-së pranimin e kërkesës për vendosjen e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj prokurores A.K., për shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronjat “g” dhe “j” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. KLP vendosi ta pranojë këtë kërkesë dhe të vendosë masën disiplinore të propozuar nga ILD.

## SESIONI I PYETJE-PËRGJIGJEVE TË ILD-SË NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE



**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** Tani, do t'ia kaloj zonjës Bylykbashi fjalën për të bërë një relativitet në emër të komisionit, me qëllim, që gjërat që ju i keni të shkruara në raport, të kemi mundësi të dalin edhe nëpërmjet pyetjeve të kolegëve.

**Deputete Aulona Bylykbashi:** Faleminderit kryetar, i nderuar Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike në përmbushje të funksionit të tij kushtetues, të mbikëqyrjes parlamentare, shqyrtoi raportin vjetor për vitin 2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një prej institucioneve themelore në arkitekturën kushtetuese të reformës në drejtësi. Roli i tij në garantimin e përgjegjshmërisë, integritetit dhe standardeve profesionale të magistratëve është një komponent i domosdoshëm për forcimin e besimit të qytetarëve tek sistemi i drejtësisë. Nga analiza e komisionit rezultoi se gjatë vitit 2025, ILD ka vijuar procesin e konsolidimit institucional dhe ka bërë progres të dukshëm në disa drejtime të rëndësishme. Në mënyrë të veçantë, vlerësohet pozitivisht fakti që shumica e rekomandimeve të Kuvendit për vitin 2025 janë zbatuar, ose janë në proces zbatimi. Në fakt, nga tetë rekomandime, shtatë janë të zbatuara plotësisht, të përmbushura, dhe një është i përmbushur pjesërisht. Janë ndërmarrë hapa konkretë për formalizimin e monitorimit të rekomandimeve të inspektimeve, për zhvillimin e raporteve analitike mbi ankesat e marra, për forcimin e transparencës institucionale si dhe për avancimin e procesit të dixhitalizimit të veprimtarisë së institucionit. Gjithashtu, komisioni vlerëson orientimin gjithnjë e më të madh të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejt inspektimeve tematike, analizës së problematikave sistematike dhe përdorimit të të dhënave statistikore si bazë për planifikimin e veprimtarisë inspektuese. Raporti tregon se gjatë vitit 2025 janë administruar mbi 3200 ankesa, duke reflektuar kështu një nivel të lartë të besimit të qytetarëve te ky mekanizëm institucional. Një pjesë e konsiderueshme e tyre lidhen me vonesat procedurale, arsyetimin e vendimeve dhe cilësinë e administrimit të drejtësisë, çka evidenton se sfidat kryesore të sistemit vazhdojnë të jenë më tepër të natyrës strukturore sesa individuale. Në të njëjtën kohë, komisioni vëren se veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të vlerësohet vetëm në bazë të volumit të çështjeve të trajtuara,

por mbi të gjitha në bazë të ndikimit real që inspektimet dhe rekomandimet e tij prodhojnë për përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë. Dhe në këtë drejtim mbeten ende sfida të rëndësishme. Vakancat në trupën e inspektorëve vijnë në ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetet institucionale dhe në kohëzgjatjen e procedurave. Proces i dixhitalizimit, megjithëse ka hyrë në një fazë të rëndësishme të zhvillimit, kërkon një përshejtim të mëtejshëm. Po kështu mbetet e nevojshme forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, veçanërisht në drejtim të aksesit në sistemet elektronike dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të inspektimeve. Komisioni vlerëson se një pjesë e problematikave të evidentuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk burojnë vetëm nga veprimtaria e vetë institucionit, por lidhen edhe me sfida më të gjëra të sistemit gjyqësor, siç është ngarkesa e lartë e gjykatave dhe prokurorive, vakancat, administrimi procedural dhe menaxhimi i çështjes. Në këtë kuadër, komisioni kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit të mekanizmave të matjes së impaktit të rekomandimeve, përdorimit të metodologjive bazuar në analizën e riskut, forcimit të kapaciteteve analitike dhe krijimit të sistemeve moderne të monitorimit të performancës institucionale. Një aspekt me rëndësi të veçantë është edhe dimensionin europian i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Raportet e Komisionit Europian evidentojnë se institucioni ka konsoliduar rolin e tij në arkitekturën e reformës në drejtësi dhe ka kontribuar në mënyrë aktive në procesin e integritetit europian, veçanërisht në kuadër të kapitullit 23 dhe të mekanizmave të monitorimit të sundimit të ligjit. Në të njëjtën kohë, partnerët ndërkombëtarë vijnë të theksojnë nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale, plotësimin e vakancave, standardizimin e procedurave të inspektimit dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmave të përgjegjshmërisë. Komisioni i konsideron këto rekomandime si një orientim të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. Njëkohësisht, komisioni konsideron se ekziston ende hapësirë për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, për forcimin e ndikimit të rekomandimeve dhe për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave modernë të monitorimit dhe analizës së performancës në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Po, faleminderit zonja Bylykbashi. Tani mbledhja është e hapur për pyetje. Kush ka pyetje, ose nëse ka edhe pyetje, edhe diskutim bashkë, ju lutem, po fillimisht për pyetje. Kush ka pyetje? Ne kemi patur raportim këtu në komision edhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, edhe Prokurorin e Përgjithshëm. Tani kemi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë sot. Kush ka pyetje dhe kush ka ndonjë merak? Është i lirë. Jo, Zëgjineja po pret ta fillojë dikush tjetër përpara e ta marrë fjalën nga mesi. A kupton? Kështu që opozita pret të dëgjojë të gjithë ne, pastaj të bëjë pyetje dhe me sa shoh unë s'do ketë pyetje hiç. Jo, s'ka rëndësi, ti merre fjalën.*

**Deputete Aulona Bylykbashi:** *Në fakt, unë kam vetëm një pyetje që lidhet edhe me atë që u vu re nga raporti. Shihet një numër i lartë i ankesave drejtuar institucionit tuaj që, ashtu siç e thashë edhe në relatin, nga njëra anë tregon një rritje të besueshmërisë së qytetarëve tek ky institucion, por nisur nga shqyrtimi që i keni bërë këtyre ankesave, a kemi një analizë apo të dhëna përfundimtare nga vendimet e marra për këto ankime, të cilat, kërkojnë një zgjidhje apo një referim edhe me një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet e tjera të drejtësisë për të përmirësuar pastaj procesin gjyqësor në funksion të marrjes së një drejtësie më të shpejtë në kohë, dhe më të drejtë për qytetarët? Sepse edhe nga raporti vihet re që ky bashkëpunimi, me institucionet e tjera, me KLGJ-në, me KLP-në, me Prokurorin e Përgjithshëm, duket sikur është një bashkëpunim akoma në terma formal, pra në një thirrje reciproke në grupe pune, pa të dhëna. Më konkretisht cilat janë rezultatet e këtij bashkëpunimi, cilat janë fushat në të cilat keni bashkëpunuar? Por është shumë e rëndësishme që këtë bashkëpunim ta shikojmë në këtë kuadër, pra në kuadrin e të dhënave të nxjerra nga vendimet e ankimit, dhe se si? Cilat janë këto dhe pastaj se si referohen në këtë bashkëpunim për të ndikuar pastaj tek procesi normal i vendimmarrjeve gjyqësore, që kryesisht lidhet me dhënien e drejtësisë në një kohë të rregullt, në një kohë të arsyeshme. Faleminderit.*

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Po, zoti Metani.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Faleminderit, e nderuar deputete. Përgjigja e shkurtër është jo, por në fakt më pëlqen shumë ideja dhe s'e kisha menduar kështu si e ngritët ju. Dhe është një nga gjërat që duhet të bëjnë institucionet e drejtësisë. Pra, ky lloj raportimi, problematikat që ne i ngremë, së pari duhet të diskutohen me njëri-tjetrin para se të vijnë këtu, mendoj unë. Pra, si me thënë, edhe nëse janë kompetenca të ndara, ILD, KLGJ, KLP, gjithsesi kemi gjuhë të përbashkët vlerash, mbi të cilat ne duhet të bashkohemi për të zgjidhur këto situata, me të cilat ne përballemi. Bashkëpunimi i vërtetë, është e vërtetë ajo që thoni, është më shumë formal sesa njerëzor, i natyreshëm. Kjo vjen për shumë arsye dhe s'është nevoja për të ndarë, domethënë, as përgjegjësi, se e tillë është marrëdhënia. Për hir të së vërtetës, është për të evidentuar përpjekjet e të gjithë institucionit. Domethënë, ne kemi qenë gjithmonë promovues dhe proaktivë për të thirrur mbledhjet e përbashkëta që në vitin 2022, për të folur për gjërat që na shqetësojnë. Janë bërë disa takime, për hir të së vërtetës nuk është se kanë qenë shumë frytdhënëse në këndvështrimin e prodhimit të një gjetjes së një gjuhe të përbashkët për shqetësimin që kemi. Por gjithsesi takimet po rrihen në lëvizje, edhe nëpërmjet asistencës që Bashkimi Evropian ka dhënë me misionet e veta për t'i facilituar këto lloj takimesh. Por mendoj që bashkëpunimi nuk është çështje ligji apo çështje "o e ke ose s'e ke!". Domethënë dhe kjo është një gjë që do kërkojë kohën e vet, do kërkojë njerëzit e vet, do kërkojë praktika të reja, është një gjë në zhvillim.

Për t'u kthyer prapë te pyetja juaj, një nga gjërat që unë mendoj se duhet të bëjmë dhe ndoshta do e bëjmë tani pas kësaj ideje që ju mua më dhatë, të paktën, është që këto lloj shqetësimesh që ne kemi, duhen bërë pjesë e diskutimeve me njëri-tjetrin. Pra, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqetësim në raport me pamundësinë e vet për të zgjidhur ankesat që drejtohen nga qytetarët për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, të cilat nuk përbëjnë domosdoshmërisht shkelje disiplinore, atëherë janë gjëra për të cilat duhet të marrë masa, duhet t'i listojë, ose të paktën t'i adresojë KLGJ, KLP apo Prokurorisë së Përgjithshme nëpërmjet mekanizmave të veta. Pra, në këtë frymë mendoj që është një ide shumë e mirë, që vetë institucionet të mbledhen dhe të flasin për këtë situatë. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Po, pyetje tjera? Po, zonja Çausi.*

**Deputete Zëgjine Çausi:** *Për ta vazhduar atë që tha zonja Bylykbashi, i bie që raporti ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka raport mirë ose nuk ka raport fare derisa nuk është arritur të hartohet edhe protokollin e bashkëpunimit. Kështu, të paktën, e shoh unë nga ajo çka dhe ju thatë pak më përpara. Pyetjen e dytë e kam përsa i përket ankesave. Pyetja e parë: çfarë bashkëpunimi keni me këto institucione? Çfarë e ka penguar këto institucione për të arritur të zbatojnë ose të hartojnë protokollin e bashkëpunimit? Se ju thatë që kemi bërë mbledhje, por nuk kanë funksionuar dhe nuk kemi arritur asnjë gjë nga këto mbledhje, të paktën kështu u kuptua nga ana ime. Pyetja e dytë ishte përsa i përket ankesave. Duke qenë se shumica e ankesave lidhen me vonesat procedurale dhe vendimmarrjen, cilat do të jenë prioritetet e inspektimit për vitin 2026? Pyetja e tretë: A mendoni se nevojiten ndryshime ligjore për t'i bërë rekomandimet e ILD-së më detyruese? Faleminderit.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Po, faleminderit zonja Çausi. Pyetjen e parë ndoshta u shpreha unë gabim, por nuk kisha ndërmend dhe nuk është e tillë, që bashkëpunimi nuk funksionon. Bashkëpunimi duhet të ishte më efikas, se është shumë e rëndësishme kjo ndarje. Pra, ne e bëjmë detyrimin ligjor, takohemi, diskutojmë, por çështja është që përtej këtij detyrimi ligjor ka dhe motivim individual, që jo gjithmonë e gjej të shprehur nëpër mbledhje apo nëpërmjet formës së bashkëpunimit, që duhet të kenë këto organe qeverisjeje. Dhe kjo nuk është çështje e organeve të drejtësisë, është e jona. Tani duhet të jemi edhe të ndërgjegjshëm me atë që ndodh. Domethënë, kjo është një veçori që nuk është vetëm për ata që punojnë tek organet e drejtësisë. Padyshim, takimet duhet të ishin më efikase, por fakti që institucionet takohen, fakti që edhe zgjidhin gjëra, tregon që edhe funksionon. Por duhet të ishte shumë më efikas, duke e parë këtë në raport me nevojat që ka sistemi, në raport me nevojat që ka shoqëria sot dhe në raport me kulturën e re institucionale, që duhet të prodhojnë institucionet, domethënë, jo thjesht institucionet e drejtësisë. Por kjo shkon përtej. Ky është një mendim i imi për këtë që diskutojmë. Së dyti, prioritetet e inspektimeve, ne i kemi përcaktuar në kalendarin që është miratuar në janar të vitit 2026, ndonjë gjë e ceka, por dua t'ju tregoj, se si i përzgjedhim ne temat e inspektimit. Së pari, i përzgjedhim nga analiza e objektit të ankesave që i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pra për çfarë ankohen qytetarët më shumë. Së dyti, marrim parasysh edhe informacionet që na vijnë nga gjykatat dhe nga Prokuroria, informacion periodik që ne i kërkojmë gjykatave dhe Prokurorisë për të parë problematikat që hasin ata.

Së treti, nëpërmjet burimit të informacionit, edhe nga institucionet e tjera, pra kur ata propozojnë inspektime tematike, siç ka qenë rasti i këshillave, Prokurorisë së Përgjithshme, apo nëse ka ankues që ngre një problem, apo fenomen në sistem, ne prapë e trajtojmë në mbledhjet me inspektorët, edhe duke pasur parasysh burimet njerëzore që kemi, kohën, llojin e inspektimit, arrijmë te kalendari, i cili është publik në faqe. Këtë vit kalendari parashikon 9 inspektime tematike, të cilat në këndvështrimin tonë prekin themelin apo thelbin e shqetësimeve që kanë qytetarët nga kohëzgjatja tek planifikimi i seancave gjyqësore, efektiviteti i punës së magjistratëve nëpër seanca, e kështu me radhë. Në lidhje me vazhdimin e pyetjes së dytë: a ka nevojë për ndryshime ligjore për t'i bërë detyruese rekomandimet? Në fakt, është cekur edhe në diskutime të mëparshme. Personalisht, mendoj jo, sepse rekomandimi është rekomandim, domethënë, lidhet me atë që thashë në fillim, domethënë, përtej detyrimit ligjor, institucionet duhet të kenë dhe motivimin për të bërë gjërat dhe jo çdo gjë zgjidhet me detyrim, jo çdo gjë zgjidhet me forcë. Gjërat zgjidhen me besim tek puna e njëritjetrit dhe me marrëdhënie institucionale njerëzore korrekte, se duhet të marrim edhe inversin, nëse rekomandimet që prodhon institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund të ishin problematike. Pra, si me thënë, procesi i rekomandimeve që nxjerr Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të jetë proces konsulte me institucionin, që zbaton rekomandimet. Duhet të jetë proces dinamik i plotësimit të tyre apo edhe ndryshimit të tyre, nëse institucionet gjejnë shkak a vështirësi për t'i plotësuar. Si me thënë, është një gjë që është e vështirë që të jetë e detyrueshme me ligj ndjekja e rekomandimeve që nxjerr institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këndvështrimin tim personal. Por gjithsesi, ndoshta kjo kërkon një analizë më të thellë, por reagimi i parë i imi për këtë pyetje ky ishte.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Po e ka kërkuar fjalën për pyetje kolegu Komici.*

**Deputet Olsi Komici:** *Faleminderit kryetar, i nderuar zoti Metani. Tani, natyra e pyetjeve e ankimeve që vijnë në institucionin tuaj kuptohet që ka larmishmëri. Ka ankime që vijnë për korrupsion, për vendimmarrje të padrejta që në një farë mënyre interferojnë njëra-tjetrën. Pra, aty ku aludohet për vendimmarrje të padrejtë, në një përqindje të konsiderueshme lidhet edhe me faktin e korrupsionit. Gjithashtu, ka edhe ankime të natyrës që vendime të ndryshme të gjykatave zbardhen me vonesë për arsye nga më të ndryshmet, qoftë të karakterit objektiv, qoftë edhe të karakterit subjektiv. Unë, në radhë të parë, do të doja të dija në lidhje me një perceptim tuajin apo me opinionin tuaj, qoftë të karakterit institucional apo edhe personal, nisur nga eksperiencia mjaft e gjatë që ju keni në fushën e drejtësisë në institucione të ndryshme shtetërore. Pra, duke si të thuash, a keni bërë ndonjë analizë në lidhje me këtë raportin, po themi, pra ankime në lidhje me korrupsionin apo me vendimmarrjet, pra, të padrejta, në raport me vendimmarrjet tuaja? Dhe ajo çka më intereson mua më shumë është si shkon ajo balanca e perceptimit të publikut, pra kthimi i besimit të drejtësisë te publiku, si shkon ky raport, domethënë, cili është perceptimi i publikut në opinionin tuaj nga analiza e apo nga vendimmarrjet që ju keni bërë në lidhje me ankesat e kësaj kategorie? Dhe pyetjen e dytë e kisha në lidhje me backlog-un, që në fakt është një gangrenë në institucionet e drejtësisë, qoftë në Prokurori apo edhe në gjyqësor. Marr shkas nga fakti i elementit të zbardhjes së vendimeve. Do të doja një opinion tuajin, domethënë, si mund të veprohet, ose ndonjë një procedurë, ndonjë element ndihmues, nisur edhe nga eksperiencia juaj më shumë, që mund ta ndihmojë uljen e backlog-ut. Faleminderit.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Atëherë, në lidhje me pyetjen e parë, sipas ligjit, çdo vendimmarrje e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është e ankimeshme pranë këshillave, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëse ankesa është për prokuror, apo pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse ankesa është për gjyqtar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka bërë një fushatë shumë të madhe ndërgjegjësuere për dy gjëra: e para, që i ka kërkuar çdokujt, çdo qytetari, institucioneve dhe çdokujt të interesuar tek punët e drejtësisë të paraqesë ankesë. Pse? Është e rëndësishme të paraqitet ankesë, sepse vetëm nëpërmjet kryerjes së këtij procesi, ankuesi ka të drejtë, *së pari*, të marrë informacion për atë që po ndodh brenda zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me trajtimin e ankesës dhe *së dyti*, i lind e drejta për të ankimuar vendimmarrjen e ILD-së, nëse ngelet i pakënaqur me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse kjo është mënyra e vetme për ta bërë institucionin të kontrollueshëm. Dhe vërej me kënaqësi, që edhe numri i ankesave që qytetarët kanë ndaj vendimmarrjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuptimin e ankimit që bëjnë në Këshilla, nuk është një numër i vogël. Po po ashtu, jam i kënaqur nga ana tjetër, që në asnjë rast Këshillat nuk kanë, siç e evidentova më sipër, as Këshillat, as Kolegji i Posaçëm i Apelit, kur e ka pasur mundësinë, apo GJEDNJ, në ato raste që ka pasur shqyrtim, nuk kanë kthyer procedura të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si të paplota, si joprofesionale, si me standarde të dyfishta. Dhe për mua kjo është më e rëndësishmja. Në 8 mijë e ca ankesa që i ka drejtuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë në këto gjashtë vite, nuk ka asnjë rast që të evidentojë që Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka mbajtur standarde dyfishta në rastin X apo rastin Y. Dhe kjo lidhet edhe me atë që ju e vazhdoni pyetjen, raporti i perceptimit publik për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Nuk e di çfarë kishit parasysh, si është raporti i perceptimit publik për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, apo ndoshta e kuptova gabim? Ah, ok! Në lidhje me sistemin e drejtësisë, edhe kjo është një gjë që do mekanizëm, do metodologji dhe do sigurisht institucione të tjera, që e kryejnë këtë proces. Për mua dhe inspektorët që punojnë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është dhe ka qenë e rëndësishme, që nga dita një e deri më sot, të zbatojmë atë që kemi detyrim. Pra, atë detyrim që ka përcaktuar protokollin kushtetues dhe ligji. Nëse ky mekanizëm që ka zgjedhur ligjvënësi, duke miratuar ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, do kthehet pastaj në perceptim të rritur publik, kjo është çështje tjetër. Por Inspektori i Lartë i Drejtësisë po zbaton rigorozisht atë detyrim që ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligji dhe kjo pastaj ndoshta ka nevojë për analizë më të hershme, nëse do prodhojë patjetër perceptim apo jo, të rritur për punën e sistemit të drejtësisë. Por në çdo rast, nëse mund ta zgjas pyetjen, sepse është shumë e rëndësishme, sistemi llogaridhënës ka dy komponentë shumë të rëndësishëm: përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë. Përgjegjshmëria lidhet me elementë, që kanë të bëjnë me emërimin e magjistratëve, me formimin fillestar të magjistratëve, me kontrollin e pasurisë së tyre, me rolin e gjykatave më të sipërme për të kontrolluar punën e gjyqtarëve-prokurorëve, me garancitë që duhet të kenë apo kontrollat për integritetin e magjistratëve nëpërmjet institucioneve përkatëse. Pra, pasi funksionon i gjithë ky sistem përgjegjshmërie, nëse diku çalon dhe nuk ecën, atëherë kalojmë te sistemi i përgjegjësisë dhe përgjegjësia është civile, penale, administrative. Dhe Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar mekanizma, të cilat vënë në lëvizje këto tre lloj përgjegjësisë. Por nuk mund të kërkojmë zgjidhjen e situatave apo mosfunksionimin e një hallke nga përgjegjshmëria, domosdoshmërisht me zgjidhjen apo me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Kjo është shumë e rëndësishme për mua dhe prandaj them, raportet nëpërmjet institucioneve duhet të jenë më fleksibile, për të kuptuar pikërisht këtë rol që kemi dhe për të kontribuar aq sa mundemi, sepse jo gjithçka varet nga puna e institucioneve të drejtësisë.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Varet nga, po them, nga infrastruktura, që kërkon një tjetër lloj bashkëpunimi, edhe me qeverinë, edhe me Kuvendin. Pra, si me thënë, është kompleks i gjithë ky proces. Prandaj është shumë e vështirë që të matet perceptimi në këndvështrimin tim, sepse situata është ajo që është, por është një mekanizëm shumë i madh që duhet të funksionojë i gjithi më së miri. Po të mos funksionojë një hallkë, ka efekt në të gjithë zinxhirin e punës së institucioneve të tjera. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** Faleminderit, zoti Metani, zoti Bylykbashi!

**Deputet Oerd Bylykbashi:** Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit për raportimin, i nderuar Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Zoti Metani, ne për më pak se një muaj, bëjmë 10 vjet që miratuar me 140 vota reformën në drejtësi, ndryshimet kushtetuese, se më pas reforma në drejtësi devijoi nga ajo që u miratua. Edhe ajo që u miratua është me probleme, por megjithatë mori atë konsensus që mori atëherë dhe besoj që nuk ka ndonjë ekuivok këtu, qoftë duke u nisur nga kryetari, kemi qenë në të njëjtin komision të reformës së drejtësisë, por edhe të tjerë që kanë ndjekur qëndrimet e mia publike gjatë këtyre 10 viteve. Kritika ime kryesore ka qenë tek arkitektura e sistemit, në mënyrë specifike tek fragmentimi i sistemit të drejtësisë. Në fillim, madje, numri i akronimeve të institucioneve ishte i tillë që edhe eksperti më i mirë i harronte rrugës, nuk shkonte dot deri tek i fundit, por një pjesë u shkurtuan. Pra, sistemi do të ishte edhe më i thërmuar sesa ky që kemi sot. Dhe një nga problemet që do të prodhonte, pra, ulur në tryezë, ta shihje në letër, këto institucione, nëse s'do hyjnë në konflikt, do t'u duhet kohë të gjejnë fjalën me njëra-tjetrën. Ku e kam unë, ku e ke ti? Kur ta çojë dikush, do ta zbatojë tjetri apo jo, është çështje tjetër. Dhe nga ajo që ju raportoni, nuk është hera e parë, por është e disata herë, por edhe nga përgjigjet që ju dhatë, pra, kuptohet një lloj, po themi, pra, kuptohet pikërisht një lloj frustracioni në ushtrimin e nevojën për të ushtruar një detyrë kaq të rëndësishme. Pra, ju praktikisht jeni si një nga ato elementet kyç të sistemit. Debatimi për inspektorin që dilte jashtë, pra, të ishte një institucion i veçantë, shumë i vjetër, shumë më i vjetër sesa 2016-ta, heqja nga Ministria e Drejtësisë e pjesës, pra, te mbetetja në pjesën e sistemit të magistraturës për të qenë më i pavarur. Por ja ku jemi. Pra, ju bëni rekomandime dhe më pas vendosin të tjerë do ta bëjnë apo jo. Ju thoni që ka bashkëpunim, por mbetet tek pjesa formale, më pas nuk ka ndjekje. Pra, edhe unë jam dakord me atë që thoni ju. Dy gjëra, pra jo vetëm që është e brendshme, nuk është vetëm që je i detyruar të bashkëpunosh në nivele kaq të larta kushtetuese, është dhe nder që ta ushtrosh atë funksion dhe pjesa e saj është të jesh aktiv që ky sistem të funksionojë edhe më mirë se ç'është shkruar. Kështu e besoj unë dhe kjo ka qenë një nga shpresat që, pavarësisht një dizajni të keq kushtetues të sistemit të drejtësisë, vullneti i përgjithshëm dhe individuali i mirë do ta bënte të plotësonte boshllëqet. Por, me sa duket, jemi këtu ku jemi dhe kemi këtë situatë. Gjithashtu, jam dakord me atë që thoni ju. Ndoshta s'është e domosdoshme të ndryshojmë ligjin, sepse neve vazhdimisht gjejmë si recetë ndryshimin e ligjit. Është shumë e vjetër si shprehje, rreth 25 vite e vjetër, shprehje e një organi tjetër, jo për këtë, por për çështje të tjera, thoshte: "Ndryshimi i ligjit nuk është recetë për të zëvendësuar mungesën e vullnetit të mirë. Sado ne mund të shkruajmë, do të ketë përsëri, do të kemi ligje më pas të tmerrshme që kapërcejnë dhe aktet nënligjore më të detajuara. Ne nuk mund ta bëjmë këtë. Bëhet i thyeshëm, i pazbatueshëm, etj. Megjithatë, ka një numër shumë të lartë ankesash që vijnë tek ju dhe ndoshta kur ju nuk ktheni përgjigje, pra, një pjesë është diskutimi im, janë konstatime, do të shpreh se ne mund të bëjmë pyetje vazhdimisht nga një raportim tek tjetri, nuk ndodh gjë.

Ajo që për shembull, unë dua të kuptoj është sa pjesë e këtyre ankimeve që vijnë, pra, ju i filtroni, i analizoni, janë ankime për mënyrën si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sa janë se në fund fare sistemi, jo sistemi i drejtësisë, sistemi, po themi, le të themi, administrata, shteti i ka detyruar njerëzit të përplasen në një sistem që në fund të fundit mbetet "grykë shishe". Gjyqësori i tillë është minimalisht për shkak të procedurave, është më i shtrënguar, nuk është kaq i shkathët në zgjidhjen e problemeve, përndryshe do të bënte gabime. Pra, janë detyruar të shkojnë aty të përplasen në një sistem, i cili ngarkohet e ngarkohet e ngarkohet dhe në fund fare nuk e kuptojnë më ku e kanë hallin. Pra, ju sa kuptoni nga ky lloj, ky volum, ju thatë 8 mijë ankesa në gjashtë vite, ndërkohë që referoheni në një numër tjetër prej 3 mijë e ca janë të vitit. Pra, në gjashtë vite janë mbi 8 mijë dhe rreth 3 mijë janë të fundit. Pra, numrat janë shumë të lartë. Nuk gjendet dot zgjidhja tek ILD-ja, nuk zgjidhet tek gjyqësori duke çuar çdo gjë atje. Pra, përplasen njerëzit tek gjyqësori, pastaj kërkojnë hallin. Dikur e kërkonin tek vetingu. Vinin ankesa për të kërkuar zgjidhjen, kërkonin zgjidhjen tek vetingu. Më pas, tani është tek SPAK-u, ndoshta do të jetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kudo do të spostohet gjithmonë fokusi. Problemi, në fakt, është diku tjetër. Pra, njerëzit detyrohen të shkojnë tek gjyqësori. I kërcet një gjobë shumë e thjeshtë, nuk gjen zgjidhje. Mundësinë për të ankuar s'e ka kollaj, e ka të vështirë barrën. Ka dhe perceptimin që është i tmerrshëm. Hyrja në sistemin e drejtësisë është si ai shkrimi tek "Ferri i Dantes": "Lini çdo shpresë ju që hyni këtu". E ke mbyllur historinë. Është shumë e thjeshtë. Nëse bën dikush llogarinë që i duhen sot 16 vite që të mbarojë procesin, pastaj vjet ishte përmirësuar me 16 ditë, tani mund të jetë përmirësuar edhe me ca ditë të tjera, pra, mund të ketë zbritur pak. E humbet shpresën kushdo që mendon që mund të gjejë një zgjidhje për lekë, për pronë, për një padrejtësi tjetër, çfarë, për një kontratë. Rreth dy të tretat e backlog-ut janë proces civil dhe administrativ, pjesa më e madhe civile dhe administrative, ndërkohë që pjesën tjetër e zë pjesa penale dhe SPAK-u është një fraksion. Ne flasim të gjithë për SPAK-un, në fakt, problemet janë të tjera. Tani, të gjithë ata janë në një proces civil ku palë janë dy persona që s'kanë lidhje me shtetin. Kur mendojnë ata që çështjen që kanë do ta zgjidhin pas 16 viteve, ata tmerrrohen. Sigurisht që kjo do të çojë edhe më shumë ankesa tek juve, se në fund fare njëra palë mendon që është bërë padrejtësi e tjetër dhe ajo që ndodh. Po kemi një përkeqësim të sistemit, të performancës së sistemit. Nuk e di nëse juve jeni në gjendje, por sigurisht që mua më intereson të kuptoj pse në gjithë këto çështje të shqyrtuara, mbi 1600 çështje të shqyrtuara prej jush, janë vetëm 13 procedime dhe vetëm 8 magjistratë të çuar. E kuptoj që shpeshherë nuk ka prova, ashtu i është mbledhur shpirti dhe nuk durojnë dot më atë padrejtësi që po heqin. Ne nuk kemi pafundësi gjyqtarësh. Zgjidhja nuk është, ndoshta unë e kuptova kështu, që nuk është vetëm masa më e rëndë disiplinore, pra, duhet edhe të kuptojnë gjyqtarët që duhet të ndryshojnë kurs eventualisht ose prokurorët, por numri është i vogël. A është edhe për shkak se ju nuk gjeni që rekomandimet tuaja janë efikase, se KLGJ-ja dhe KLP-ja nuk ju përgjigjen? Sepse në qoftë se ky thërmim i sistemit që thashë përpara, pra, e bën herën e parë, herën e dytë, herën e tretë, vit pas viti sheh që nuk ka funksion, nëse duhet të mendojmë një zgjidhje tjetër të nivelit kushtetues apo jo, por nuk e di. Por ne duhet të kuptojmë prej jush, pra, këto numra të vegjël janë sepse realisht s'kanë prova apo në fund fare sistemi nuk prodhon gjë. Ia vlen të përballesh gjithë kohës me një sistem? Në fund fare ju do të bashkëpunoni me njëra-tjetrën dhe njëra dorë do të lajë tjetrën, nuk ka kush shpëton nga kjo. Domethënë vjen për shkak të kësaj dizajni që ju s'jeni përgjegjës në fund fare.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Jeni një trupë, e cila si organ monokratik që ka një administratë, që ka persona me eksperiencë, profesionistë e tjerë brenda, por në fund fare përballeni me gjithë këto ankesa dhe në fund fare kjo prodhon kaq. Njerëzit që e shohin këtë raport nga jashtë thonë: “Po kaq u mbarsë mali dhe kaq prodhoi?”. Dhe kjo është çështje perceptimi. Nuk mund t’ia vëmë këtë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është i të gjithë sistemit, e sistemit të drejtësisë. Ne jemi përpara një pothuajse një kronike vdekjesh të ngadalshme të paralajmëruar 10 vite përpara. Janë thënë të gjitha këto. Meqë ne duam t’i provojmë gjërat me formën e vështirë, duke përplasur kokën pas murit me rreth 200 mijë çështje në backlog, termi delikat në shqip është “mullar i çështjeve”. Të gjithë humbasin, nuk e kuptojnë më ku mund ta gjejnë të drejtën e vetë të kësaj sisteme atje. Nuk e di çfarë mund të bëjë ILD-ja tek kjo çështje, por prapëseprapë duhet patjetër që, mirë keq, në qoftë se KLGJ-ja dhe KLP-ja, se ata në fund të fundit do të gjykojnë, s’janë dakord, ju nga ana tjetër duhet ta vendosni atë pjesë në vështirësi në maksimumin e vet. Pra, nëse kompiacënca e tyre është e tillë që preferojnë të mos shkojnë në rezultate, ju bëni pjesën tuaj. Sigurisht që pjesë e zgjidhjes së gabuar është fakti që KLGJ-ja dhe KLP-ja kanë raportin shumë delikat midis magistratëve dhe jo magistratëve. 6 me 5, kufiri është shumë i lehtë për t’u kapërcyer, për të qenë në kontroll parlamenti, për rrjedhojë politika, jo trupa. Është shumë e thjeshtë dhe më pas aty mund të ndikohet se si do të jenë zgjidhjet përfundimtare edhe për rekomandimet tuaja. Domethënë, mund të flasim pafund për këtë çështje, por unë desha të fokusoj, pra, nga ato elemente që mundet, mendoni që mund të më jepni një përgjigje, do ta mirëprisja, por desha të vë në pah një fakt që jemi 10 vite më pas. Vërtet, reformat kërkojnë vite, por në qoftë se na duhen edhe 10 vite të tjera dhe të gjithë kemi maksimumi 10 deri në 30 vite jetë aktive profesionale, dhe njerëzit nuk mund të presin dot pafundësisht që një sistem të funksionojë dhe ta mendojnë qysh sot që të lejnë trashëgimi mënyrën se si zgjidhet një çështje ose si do të zgjidhet, se ata vetë nuk do të arrijnë fundin, pavarësisht se janë ata ankuesit. Faleminderit.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** Po, faleminderit zoti Bylyk Bashi, zoti Metani. Keni për të kthyer një përgjigje për zotën Bylyk bashi për ato që ju i konsideroni pyetje.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Zoti Bylykbashi bëri një panoramë, në fakt, edhe të perceptimit publik, edhe të mendimit personal për arkitekturën dhe për situatën në të cilën gjendet sistemi i drejtësisë sot. Kishte edhe politikë, jo në kuptimin e keq, por kishte edhe politikëbërje aty, kishte edhe kushtetueshmëri, pra, të drejtë kushtetuese, kishte edhe mendim. Pra, është e vështirë t’i përmbledh ato që tha, por në 2-3 gjëra që unë munda të fiksoj, me ca bie dakord me zotën Bylykbashi, me disa nuk bie dakord edhe personalisht. Për shembull, mendoj që arkitektura e sistemit të drejtësisë është më e mira që ne mund të bënim, pikërisht për ndarjen dhe balancimin e pushteteve nëpërmjet organeve të drejtësisë. U prodhuan shumë organe dhe ndoshta këtu duhet të ishin marrë masat, sepse organet duheshin plotësuar me njerëz, por kjo është çështje tjetër në këndvështrimin tim. Po flas për arkitekturën në kuptimin kushtetues. Është një arkitekturë e cila nuk mundëson asnjë institucion të jetë më i fuqishëm se tjetri. Çdokush kontrollon punën e gjithkujt dhe për mua kjo është shumë e rëndësishme. E dyta, situata ndoshta e parë edhe nga jashtë mund të jetë ashtu si thatë ju, pra, si me thënë, u mbars mali dhe polli, nga 1 mijë e 600 ankesa prodhoi 8 procedime disiplinore, ndërkohë që nuk është kështu. Sepse unë prandaj e bëra edhe prezantimin, që e para janë trajtuar 1 mijë e 600 ankesa, janë verifikuar ato. Verifikimi i ankesave do të thotë që janë marrë 1 mijë e 600 praktika pune, 1 mijë e 600 letra janë nisur nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të prokurorë X, Y dhe i ka marrë praktikën e punës, i ka thënë do monitorohet, sipas protokollit kushtetues.

1 mijë e 600 herë prokurorët dhe gjyqtarët e kanë ndjerë që puna e tyre kontrollohet dhe për mua, nëse pastaj do ketë shkak për hetim disiplinor, apo më tej për procedim disiplinor, kjo varet edhe nga provueshmëria, edhe nga natyra e ankesës. Për mua është e rëndësishme dhe prandaj edhe raportet ndërkombëtare theksohet kjo, ne mendojmë që raporti apo mekanizmi i verifikimit të punës së gjyqtarëve funksionon, sepse funksionon edhe në mënyrë kushtetuese. Për mua është shumë e rëndësishme që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si institucion monokratik, është një institucion delikat, që kërkon në këndvështrimin tim, një pjekuri shumë të madhe demokracie e politikëbërje, jo vetëm raport me Kuvendin, por në raport me gjithë shoqërinë, sepse është një institucion, ku një person, një individ ka të drejtën e firmës për të filluar ose jo një hetim disiplinor. Patjetër ju bini dakord me mua, që një hetim disiplinor i nisur për shkak të motivimit publik, por në kundërshtim me kushtetutën, është mjet shantazhi për prokurorin dhe gjyqtarin dhe kjo është balanca e rëndësishme që ne po mundohemi të mbajmë, duke marrë përsipër edhe kosto. Edhe këtë që thatë ju, që u mbars mali edhe polli 1 mi, ndërkohë që e vërteta s’është kështu. Aq janë. 1 mijë e 600 procedura. Por dua ta ndaj me ju, sepse ky është momenti që unë mund të flas lirisht, me thënë të drejtën, sepse këtu nuk po bëjmë politikë, por janë mendime edhe personale, që vijnë nga 6 vite eksperiencë. Shiko, çdo ditë kemi debate me njëri-tjetrin, emocion edhe individual për një çështje dhe kur flas për presione, jo domosdoshmërisht flasim për presione politike, jo domosdoshmërisht flasim për presione mediatike e kështu me radhë, edhe presion kundër vetes, por presion edhe në kuptimin e shoqëror në fjalës, për një çështje që ti e kupton që nuk ke mundësi të ndërhysh, sepse s’ta lejon kushtetuta, edhe pse e di që mund të kishte qenë i tjetër lloj natyre vendimi nga gjyqtari prokurori. Dhe kjo është garancia më e madhe, që po mundohemi t’i japim gjyqtarëve dhe prokurorëve, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kaq delikat si institucion, po mundohet të ruajë këtë balancë të rëndësishme kushtetuese, jo si benefit për ju gjyqtarët, prokurorët, por që ju të ndiheni të lirë që të ushtroni detyrën tuaj, por natyrisht të lirë jo vetëm nga politika, por edhe nga interesa tjera, financiare e kështu me radhë. Të konsolidosh këtë mentalitet tek trupa gjyqësore nuk ka lidhje vetëm me ushtrimin e kompetencave, është një pjekuri edhe shoqërore, që gjyqtarët do t’i arrijnë me kohë, se proces është dhe këtu jemi. Pra, për të qenë gjyqtar i mirë, është shumë e vështirë që gjyqtarët në këndvështrimin tim të kuptojnë, që janë 24 orë gjyqtarë, jo 8 orë gjyqtarë. Gjyqtar dhe prokuror është mënyrë të qeni, mënyrë të menduari, nuk është profesion. Por kjo është një gjë që e mendoj unë e ti, apo edhe ne të gjithë këtu bashkë, por jo të gjithë e mendojnë kështu dhe imponimi i këtij lloj mentaliteti me procedurë disiplinore do të bënte të kundërtën, do e bënte mjet shantazhi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për mua është shumë e kollajtë, edhe për të qenë i sinqertë, domethënë, që në 8 mijë ankesa, të kalohet në 8 mijë hetime disiplinore, ndoshta do të kisha arritur një perceptim publik më të mirë, por ama do e kisha kthyer institucionin në një mjet represioni, jo thjesht për vete, por edhe për ata që do vijnë pas meje. Për mua është shumë i rëndësishëm standardi, jo vetëm për punën që ne po ngremë sot, por edhe për ata, që do mundohen ta zhbëjnë nesër. Dhe unë këtë do të doja që ky komision të vlerësonte, në raport me punën që bën Inspektori i Lartë i Drejtësisë, se padyshim po të shkojmë në perspektivë publike, ke bërë kaq ankesa, është e humbur beteja, sepse situata nuk flet në favor të organeve të drejtësisë, jo për fajin e tyre, ose jo domosdoshmërisht për fajin e tyre. Ne shkojmë, kontrollojmë gjyqtarë dhe prokurorë për kalimin e afateve për zbardhjen e vendimeve dhe kur shkojmë atje, nuk kemi ku ulemi, se s’ka vend, dosje plot dhe tani, edhe në pikëpamje njerëzore, si mund të nis unë një hetim disiplinor kur unë po e shoh që ai s’ka mundësi njerëzore ta zbardhë një vendim? Si mundet? Domethënë, unë nuk e di.

Dhe këtë po mundohemi të bëjmë, që në rast se ne e shohim neglizhencë nga puna e gjyqtarit dhe prokurorit në vonesa për zbardhjen e vendimeve, atëherë ndërhyjmë edhe fort. Kemi çuar një numër të madh magistratësh për shkarkime, edhe pse Këshillat kanë vlerësuar që nuk e meritojnë shkarkimin, por ama në asnjë rast Këshillat nuk kanë thënë që procedimi disiplinor është i pabazuar, për t'i dhënë mesazh magistratëve që këto lloj shkeljesh do të vijnë. A mund të bëhet më shumë? Po, po, po, padyshim mund të bëhet më shumë dhe prandaj unë kam kërkuar që në vitin 2022 rol më të madh të Kuvendit, dakord, të monitoroni punën, por ne kemi nevojë të flasim. Ne kemi nevojë të ndajmë, ne kemi nevojë të koordinojmë me njëri-tjetrin dhe ky komision apo një komision tjetër kudo, një mjet tjetër, mund të ishte mjeti më i mirë që edhe ne t'i shprehim, jo në kuptimin e kërkim llogarie, se llogaridhënia është tjetër proces, por ndarja e këtyre shqetësimeve dhe si mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin, sepse çdo gjë nis nga besimi te njëri-tjetri, që puna që bëni ju këtu dhe puna që bëjnë ata atje nis nga bazamenti, ndershmëria dhe korrektesa me ligjin dhe vetëm kjo mund t'i shtyjë gjërat përpara, si në raport bashkëpunimi me institucionet e drejtësisë, por edhe në raport bashkëpunimi që kanë institucionet, drejtësia me Kuvendin. Po, është shumë e gjatë si thatë edhe ju.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Po, faleminderit zoti Metani.*

**Deputet Oerd Bylykbashi:** *Ju lutem, të shtoj një gjë të fundit. Pra, unë e di, jam dakord me atë që arsyeya pse u bë kjo lloj arkitekture ishte për të krijuar kontroll dhe balanca brenda sistemit, por u kapërcye në nivelin e kësaj. Sistemi është më i ndarë dhe i balancuar se ç'duhet, duke e bërë më të vogël raportin me pushtetin tjetër që është ekzekutivi dhe kjo e ka ekspozuar. Pra, nëse ju jeni element balance i brendshëm, unë do të kurseja, pra, në asnjë rast nuk do të sakrifikoja Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, por mund të sakrifikoja një nga dy këshillat: një këshill i vetëm, një organ suprem i magistratëve, i cili qëndronte ballë për ballë në të njëjtën kuotë, në të njëjtin nivel, kushtetues, por edhe aura që ka një institucion kushtetues, në raport me pushtetin tjetër, parlamentin qoftë, apo ekzekutivin, që është problemi i madh gjithmonë. Pra, në këtë aspekt, edhe kjo ka prodhuar më pas atë që kur administrata nuk ka frikë më nga gjyqësori se nuk i ndodh më gjë, nuk i kthehet më gjë mbrapsht, thjesht krijon padrejtësi. Padrejtësitë shkojnë në gjyqësor, njerëzit ankohen dhe i ngarkohet dhe sistemit. Në këtë logjikë e kisha. Faleminderit.*

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Ka pyetje të tjera? Kam një pyetje unë përpara se sa t'i them dy fjalë për raportin zoti Metani. Rezultatet e inspektimeve tematike dhe individuale i publikoni në faqen zyrtare të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë? Dhe e dyta, numri i madh i ankesave që doli këtu, që ka një numër relativisht të konsiderueshëm ankesash të mbartura, por dhe të reja dhe që zonja Bylykbashi e tha që mund të merret edhe si tregues i rritjes së besimit tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por mund ta shohësh edhe në këndvështrimin tjetër të sëmundjes që ka sistemi. Pra, mund ta shohësh në të dy anët e medaljes rritjen e numrit të ankesave. Jam kurioz të di, nisur nga raste individuale të bëra publike në media që ka të bëjë me një nga shkaqet e ankesave që janë vonesat në arsyetimin e vendimeve dhe kam parë dhe arsyetime, vendime të arsyetuara në një kohë që vështirë se një njeri që i thotë vetes gjyqtar mund ta perceptojë dhe vetë. Çfarë thonë këta, kur i keni inspektuar? Jam shumë kurioz të di, përveç asaj që nuk kanë kushte pune se s'kanë ku ulen, edhe kjo është problematike e sistemit. Çfarë thonë kur intervistohen nga inspektorët tuaj pse shpallet një vendim me 18 muaj vonesë apo me një vit vonesë, për shembull? Arsyetohet se për të shpallur e shpallin në kohë ata. Jam shumë kurioz ta di këtë, një justifikim qoftë edhe njerëzor. Këto dy pyetje kam unë, pastaj do të them dy fjalë për raportin.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** *Po, faleminderit kryetar. Atëherë, faqja e uebit, domethënë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është shumë e pasur me informacionin që ju thatë. Pra, çdo inspektim tematik i përfunduar gjendet në faqen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, së bashku me rekomandimet, gjetjet e kështu me radhë. Inspektimet institucionale po kështu. Nuk gjenden inspektimet individuale, pra si me thënë, trajtimi i ankesave individuale, sepse janë konfidenciale, por sa i takon procesit të ankimit, në faqen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka një minikommentar, po e quaj, që i orienton qytetarët për kriteret e pranueshmërisë dhe llojin e vendimmarrjeve që jep Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ilustruar me modele, për t'i shpjeguar qytetarëve që në cilat raste ankesa është e pranueshme ose në të kundërt arkivohet. Në çdo rast, faqja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka çdo informacion që çdokush ka nevojë të marrë nga institucioni edhe pa patur mundësi ose pa detyrimin për të kontaktuar me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mendoj që është një nga faqet më transparente që ka në organet e drejtësisë, të paktën. Së dyti, mbi numrin e ankesave, edhe unë bie dakord, që rritja e numrit të ankesave, jo domosdoshmërisht tregon edhe rritjen e besimit, jo domosdoshmërisht tregon atë që thatë ju, se mund të tregojë nga ana tjetër, se për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve, fillon edhe rritja e numrit të procedurave gjyqësore, do të thotë prodhohen më shumë ankesa. Domethënë është shumë e vështirë të masësh arsyet se pse rritet numri i ankesave dhe ne nuk do të futemi në këtë lloj arsyetimi. Në raport me zbardhjen apo me vonesat, ne kemi bërë, për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, një fjali është: ngarkesa e punës. Ne vonohemi për të zbardhur vendime, sepse ka ngarkesë pune, ka ngarkesë çështjesh, kështu me radhë. Diferenca që bëjmë ne është dhe mundohemi të kuptojmë ku është ngarkesë pune normale dhe ku është neglizhencë, si në planifikimin e seancave gjyqësore, si në kryerjen e procedurave apo seancave gjyqësore, si në zbardhjen e vendimeve me vonesë nga gjyqtarët. Dhe në ato raste kur ne mendojmë që ka neglizhencë nga ana e magistratit, e cila padyshim ka sjellë edhe diskreditim të figurës së gjyqtarit, apo prokurorit, ne e kemi proceduar disiplinarisht. Për këtë arsye, edhe në këtë Komision kam deklaruar para dy vitesh për një inspektim tematik që bëjmë në Gjykatën e Tiranës. Pikërisht këtë dua t'ju shpjegoj, mekanizmin se si funksionojmë, se si mundohemi të analizojmë neglizhencën dhe ngarkesën e punës reale që kanë gjyqtarët e prokurorët. Në Gjykatën e Tiranës bëjmë një inspektim para dy vitesh besoj, për kohëzgjatjen e zbardhjes së vendimeve civile për një periudhë katërmujore, se donim të bënim një fotografim të atij momenti, pra për katër muaj çfarë ndodhi në Gjykatën e Tiranës me këtë proces, procesin e zbardhjes së vendimeve gjyqësore dhe dolën rezultatet, matëm numrin e gjyqtarëve të gjykatës, numrin e vendimeve që këta gjyqtarë zbardhin për një periudhë kohore të caktuar dhe sipas asaj analize doli që për një periudhë, zbardhja me vonesë e vendimeve fillonte nga dita 21, pra një ditë mbasi ka kaluar afati që parashikon kodi, deri në 1700 ditë. Pyetja themelore është, se që ku do e fillosh hetimin? Do e fillosh hetimin për të gjithë gjyqtarët që kanë kaluar ditën e 21 dhe kështu i bie t'i fusësh të gjithë gjyqtarët në hetim? Por natyrisht duhet të bësh një balancë, sepse edhe sikur të duash, nuk ke edhe inspektorë mjaftueshëm për të futur në hetim të gjithë gjyqtarët për kalimin e një dite të afatit për zbardhjen e vendimeve gjyqësore dhe bëjmë analizën, që në sa kohë shumica e gjyqtarëve zbardhin vendimet e veta dhe sipas kësaj na doli 120 ditë. Domethënë, shumica e gjyqtarëve, gati 90% e gjyqtarëve të Gjykatës së Tiranës, për atë periudhë kohe që matëm, i kishin zbardhur vendimet e tyre me rreth 120 ditë pasi kishin dhënë vendimin gjyqësor dhe ne thamë vetëm për këtë periudhë kohe, për gjyqtarët që i kemi gjetur tej kalimit të afatit 120-ditor, pra afatit mesatar, do t'i kalojmë në hetim disiplinor, për të parë përse i kanë zbardhur me vonesë.*

Ata që i kanë zbardhur brenda këtij afati është brenda logjikës që ka pasur ngarkesë pune, sepse ishte shumica e gjyqtarëve që kanë zbardhur vendimet dhe pasi bëmë këtë hetim, proceduam disiplinarisht gjyqtarë. Këtë e tregoj për të treguar se si funksionon, se si e mendojmë dhe si mundohemi të qasemi në raport me ngarkesën që gjyqtarët kanë, por edhe në raport me detyrimin që kanë, se tek e fundit fare qytetarët, bie dakord me zotin Bylykbashi, qytetarët nuk duan të dinë më për ngarkesat që ka sistemi apo për vonesat e sistemit. Duan vendimin gjyqësor. Gjetja e kësaj balance është shumë e vështirë dhe këtë po mundohemi të bëjmë. Faleminderit kryetar.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** Po, faleminderit zoti Metani. Në fakt, ju e thatë edhe vetë, ky është viti i gjashtë i raportimit tuaj në Komision, por këtë radhë, ndryshe nga raportimet e tjera, keni Zëvendësinpektorin e Lartë të Drejtësisë që pas gjashtë vitesh më në fund u plotësua. Edhe kjo është një problematikë që ka patur zbatimi i reformës në drejtësi, plotësimi i një pozicioni shumë të rëndësishëm në institucionin tuaj, edhe pse ju jeni institucion monokratik. Tani, ne i kemi patur këtu dhe kanë raportuar edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe prokurori i përgjithshëm. Në datën 3, në mos gaboj, kemi planifikuar edhe drejtuesin e SPAK-ut, por nga do ta vërtisësh problemin, "patatën e nxehtë" të problematikës reale që ka sistemi i drejtësisë në këto 10 vitet e zbatimit të reformës, asnjëri nuk e mban në dorë. Nuk e mbajmë as ne, as ne që jemi zgjedhur nga populli dhe që jemi pjesë e këtij Komisioni dhe e Kuvendit të Shqipërisë për t'i adresuar disa shqetësime që ka sistemi, nuk e mbajmë në dorë dhe dua ta nis nga përbërja e këshillave. Unë nuk mendoj se tek anëtarët laikë ka dorë politika. Nuk e ndaj këtë mendim, sepse po të kishte dorë politika, do ta kishim gjetur pas kaq kohësh mënyrën për t'i zgjedhur anëtarët laikë siç e ka Kushtetuta dhe ligji, por ja kemi lënë dorës së Zotit dhe anëtarët laikë që janë nëpër Këshilla, qoftë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, qoftë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, thonë: "Jemi aty nga dora e Zotit, nga goglat". Tani, problemi shtrohet që tek ne, a shkojnë prurjet më të mira dhe kapacitetet më të mira që vijnë nga avokatia, nga profesorati dhe nga shoqëria civile në Këshilla? Sigurisht që nuk shkojnë kapacitetet më të mira dhe ne kemi, nuk po them kemi hezituat, kemi refuzuar që të bashkëpunojmë në këtë pikë për të rritur kapacitetet dhe cilësitë që do të duhet të kenë Këshillat, sepse prokurorët dhe gjyqtarët i zgjedhin vetë ata. E kanë mekanizmin: gjashtë prokurorë, gjashtë gjyqtarë i zgjedhin vetë, por të paktën pjesa që çojmë ne, ne kemi vite, nuk e di sa herë janë ripërtërirë Këshillat, po më duket dy herë. Në të dy rastet janë zgjedhur me short dhe kaq e vërtetë është kjo, sa ma besoni, ka nga ata që janë aty në Këshilla që as vetë se besojnë sepse janë aty. Nuk e besojnë. Nuk dua të ndaloj te një takim që kemi patur pak kohë më parë në Durrës, mes tre vendeve tona: Rumanisë, si vend anëtar i Bashkimit Evropian; Moldavisë, si vend kandidat; por dhe Shqipërisë, që është pak një hap më përpara; dhe këshillave respektive, pra Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Moldavisë dhe Këshillit të Lartë të Magjistraturës të Rumanisë. Nuk na bën nder kur vetë përfaqësuesit e këtyre këshillave thonë që ne jemi aty se na ra Zoti, kapi goglën, në vend që të flasin realisht për shqetësimet që ka sistemi, se sistemi ka shqetësime, pa diskutim. Dhe unë dua, e nisa nga vetja, që në radhë të parë do të duhet edhe ne, kur flasim për sistemin, do të duhet të mbajmë përgjegjësitë që na takojnë, ato përgjegjësi që na ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji, xhanëm, se s'po kërkon kush të shkojë në sallën e gjyqit. Ju e thatë, por nuk është e nevojshme të thuhet që ka mungesë bashkëpunimi konkret dhe të vazhdueshëm ndërmjet organeve të sistemit të drejtësisë. Është e dukshme ajo. Unë e kam edhe nga përvoja, po është edhe e dukshme edhe nga raportimet.

Në qoftë se bëhet një mbledhje e përbashkët e dy këshillave dhe ku ftohet edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë apo Prokurori i Përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë, ajo mbledhje e përbashkët, qoftë edhe dy në vit, bëhet sepse duhen plotësuar rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit, kur në fakt është detyrim ligjor, por nuk ka rëndësi a mblidhesh a s'mblidhesh, se mund të mblidhesh dhe pesë herë në vit formalisht. Problemi është ai që ju thatë: a ka një diskutim dhe shqetësim real për sistemin kur mblidhen aktorët kushtetues të sistemit të drejtësisë? A ka një diskutim dhe përgjegjshmëri nga secili prej aktorëve për t'iu dhënë përgjigje sëmundjeve që ka si sistemi, jo thjesht dhe vetëm me 140 mijë dosjet e backlogut? Kjo është një problematikë që e kemi sot për shkak të atyre shkaqeve që dihen, që lidhen me vetingun, me mungesën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në sistem, por dhe kjo, pra ky shkak do të zhduket në fund të vitit 2028. Do t'i kemi 341 prokurorë dhe 408 gjyqtarë. Edhe pse këtu u tha që kurrë nuk do të jenë 408 gjyqtarë, sepse 25 prej tyre, për efekt të ligjit, janë në institucione të tjera, janë në KLGJ, janë në KLP, po flas për të dyja tani, janë në ILD për t'u plotësuar ai numri që është aty, shkojnë me komandim në Ministrinë e Drejtësisë. Pra, ne kemi shumë më pak gjyqtarë dhe prokurorë që trajtojnë lëndë në sallat e gjyqeve. Do ikë edhe ky shkak. Po a do të zgjidhet problemi që kemi? Dhe unë bashkohem me ju kur thoni që nuk është pozicioni pune 8 orë që të jesh gjyqtar dhe prokuror. Është përgjegjësi, përgjegjësi e një niveli krejt tjetër nga ç'janë llojet e tjera të përgjegjësisë, sepse të është besuar misioni të japësh drejtësi ndërmjet dy palëve që kanë ardhur për një hall në dyert e gjykatës. Por në qoftë se hallin që të ka ardhur në dorë, lëndën që të ka ardhur në dorë për të dhënë drejtësi, ti e sheh si diçka të huaj, si diçka të jashtme, edhe 17 muaj do të shkojë zbardhja e vendimit, do të shkojë dhe dy vjet zbardhja e vendimit, sepse nuk të dhemb. Dhe unë jam i bindur, ju e keni bërë atë inspektim tematik tek Gjykata e Tiranës, por nuk desha të zgjatëm me pyetje, se brenda asaj lënde që ju keni kontrolluar, unë jam i bindur që ka gjyqtar që kur ka dashur e ka zbardhur vendimin brenda asaj, brenda afatit procedural, dhe kur nuk ka dashur, është justifikuar me ngarkesën dhe e ka filluar ditën e 21-të, dhe pastaj shkon dhe deri në 17 muaj. Jam dhe bie dakord me ju kur thoni: Po të kapim këtë indikator të performancës së gjyqtarëve, do t'i shkarkojmë të gjithë. Por nuk është kjo zgjidhja. Ajo që më shqetëson mua është pse këto vendime i zbardhin në kohë dhe një pjesë tjetër vendimesh nuk i zbardhin, se gjithmonë ka një pse. Dhe vihet prapë tek ndërgjegja. Disiplina në punë, e kam ngritur edhe kur i kisha këtu përfaqësuesit e Këshillave. Jam dakord që qeveria do të duhet të bëjë të vetën sa i takon infrastrukturës, ore minimumin e kushteve për të punuar, por askush nuk e kontrollon disiplinën në punë sot. Si është disiplina në punë? Sepse është tek mekanizmi i reagimit. Prokuroria është pranë gjykatës. Gjyqtari, kur ka gjyqet e veta dhe kur është përbërë një trup i gjyqes, bie dakord atje, i lënë të hënën dhe të martën, i jap për hatrin tënd edhe të mërkurën, dhe pas ditës së mërkurë, deri kur vjen e hëna tjetër, nuk ke më. Gjen vetëm kryesekretarin e gjykatës atje. Mund të gesh kryetarin e gjykatës nëse banon atje ku banon, se tani ne kemi një gjykatë të madhe dhe një prokurori të madhe, se të gjithë banojnë në Tiranë. Pra, dhe ndërkohë që gjyqtarët dhe prokurorët do të duhet të punojnë si çdo zyrtar publik në këtë vend, siç punoni dhe ju 8 orë nga e hëna deri të premte, minimumi 8 orë, sepse kur ka ngarkesë, puna është dhe pa orar, por minimumi, siç punojnë të tjerët, duhet të punojnë dhe ata, se kur nuk e ndjen, kështu mbërriti puna. Edhe këta janë problematika në vete. Edhe kur i pyet se si do zgjidhet kjo gjë, na thuhet: Gjyqtarët janë të pavarur. Ore janë të pavarur në lëndën që trajtojnë, në vendimmarrjet që marrin, në vendimet që marrin dhe që japin, por nuk janë të pavarur nga ligji, nga disiplina formale në punë. Dhe kur i thuhet se çfarë duhet të bëjmë për ta adresuar këtë problem, thonë:

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

E ka në në dorë Inspektori i Lartë i Drejtësisë. " Po mirë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë që e paska për detyrë llogaridhënien e sistemit, pra kontrollin e sistemit, po ju keni vendimin. Si do ta zgjidhim këtë punë? A je qeveria e gjyqësorit? Ti a je qeveria e prokurorisë? Ti a menaxhon sistemin e karrierës së këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve? Po me sa lehtësi, kur konkurrojnë për t'u ngritur në detyrë, nëpër pozicionet që hapen vakante, nuk merren në konsideratë këto lloj shqetësimesh që ngre Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe që janë të shkruara aty në inspektimet që ka? Pra, e shohin si diçka të jashtme. Kur ti i kërkon llogari se çfarë bën KLGJ-ja apo KLP-ja në rastin konkret, të gjithë largojnë duart dhe ka një shqetësim tjetër që është ngritur: "Zoti Inspektor, këtu, pavarësisht se u dhanë shpjegimet, mirë që më në fund u zgjidh çështja e emërimit të drejtuesve, tani nuk ka kandidatë se duan të vijnë të gjithë në Tiranë. Shkojnë atje në prokuroritë e rretheve apo në gjykatat e rretheve dhe kush plotëson kriteret gjyqtar për të ardhur në gjykatë apeli apo në një gjykatë më të madhe, kur hapet gara atje, nuk futet për t'u bërë kryetar, se do të vijë këtej, në Tiranë të gjithë. Ndërkohë që unë nuk e them për mburrje, por unë vij nga sistemi. Ka qenë nder të ishte gjyqtar dhe prokuror, nder jete. Tjetra që e shoh me shqetësim këtë, nuk zgjidhet çdo gjë me kontroll, as me masat disiplinore. Dhe sa vite do të na duhen që të vijmë tek ai ndërgjegjësimi që ju thoni. Pra, do të vijë një moment maturimi edhe për këshillat, edhe për organet e tjera të sistemit të drejtësisë. Po kur do vijë ky moment maturimi? Sepse u bënë 10 vjet dhe dosjet atje...vetëm kanë filluar një studim. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nisur edhe nga ngarkesa që kanë, numri aktual dhe matrica e plotësimit të vendeve vakante në 2028 po bëjnë një studim, sa do të duhet të jetë numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve pasi të plotësohen vakancat nga vetingu. Unë do t'ju ftoja që të bëheni dhe ju pjesë e këtij diskutimi dhe ne do t'ju nxisim që të bëheni pjesë e këtij diskutimi për arsye se duhen vënë në punë të gjithë indikatorët e matshëm të sistemit për të gjykuar nëse duhet të kemi një numër më të madh gjyqtarësh dhe prokurorësh, apo nuk duhet të kemi. Dhe nuk duhet të nisemi nga backlogu. Ka standarde evropiane të CEPEJ-it të vendosura për këtë gjë, por u kemi sugjeruar realokimin e burimeve njerëzore. Për shembull, sot sistemi i prokurorisë, ka prokurori dhe gjykata që kanë ngarkesë mesatare, nënmesatare në punë, ndërkohë që gjykata e Tiranës dhe prokuroria e Tiranës janë në dyfishin e kapaciteteve. Por gjithsesi, ju do të duhet të bëheni pjesë e këtij diskutimi, sepse keni të dhënat që rezultojnë nga inspektimet tematike që bëni apo inspektimet institucionale. Ka...dhe këtu dua të bëj një sugjerim, zoti inspektor, dhe nuk e bëra kot pyetjen: A i publikoni inspektimet tematike, apo nuk i publikoni? Sepse unë e di që ju i publikoni dhe inspektimet tematike dhe inspektimet institucionale dhe i kam parë, edhe e kam parë dhe faqen tuaj, siç kam lexuar dhe raportet ndërkombëtare dhe progresraportet që nxjerr BE-ja për vlerësimin që japin për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Por ndoshta, edhe pse nuk besoj që ai që bërë më shumë ka gjithmonë të drejtë, nuk e besoj këtë. Ndoshta kur nuk marrin vesh as me prezencën tuaj me kërkesa në KLGJ dhe në KLP, dhe as me publikimin e raporteve në faqen në eëbsite, as kur ja vini në dispozicion Kuvendit, ka ardhur koha që ta institucionalizoni komunikimin me publikun, që të përcillni tek opinioni publik realisht atë që bëni, që punoni, sepse puna bëhet. Sa të tjerë vendosin t'ia përcjellin me lodra, edhe kur s'kanë ç'përcjellin, veç i bien kot. Zoti Bylybashi thotë: Çajini edhe lëkurën nganjëherë. Është e vërtetë kjo se lëkura çahet kur s'ke ç'jep. Bjeri e lodhu sa të duash, sa të çahet lëkura. Ndërsa ju, ka ardhur koha që këto rezultate të inspektimeve tematike që prekin lëndën e ankesave që keni ju, do të duhet t'i thuhet popullit: Ja ankesa, ja inspektimi, ja masat që kemi marrë. Jo se nuk e keni bërë, por kjo e krijon perceptimin që disa institucione gjasme që bërtasin më shumë, punojnë më shumë dhe disa të tjerë që bëjnë punën dhe kanë zgjedhur rrugën institucionale të trajtimit të gjërave duket sikur s'punojnë, se shifrat janë aty në fund të ditës.

Shifrat janë aty, raportet janë aty, gjyqtarët dhe prokurorët e kontrolluar janë aty, masat që janë propozuar këshillave janë aty, vendimmarrjet e këshillave janë aty. Unë nuk them që shkarkimi i gjyqtarit dhe prokurorit duhet të jetë në normë. Shkarkimi i gjyqtarit dhe prokurorit është lajm në çdo vend të botës demokratike. Nuk është kollaj të shkarkohet një gjyqtar dhe një prokuror, por të paktën kjo punë që bëhet për ta sjellë sistemin në shina do të duhet. Është, dhe ka ardhur koha tani! Keni mjaftueshëm vite mbi supë që e drejtoni atë institucion, që ato që shkruani dhe ato që punoni dhe ato që i çoni përpara Këshillave, publiku t'i dëgjojë dhe prej jush. Jo se nuk i ka dëgjuar, por duhet t'i dëgjojë. Marr kontrollin tematik, u shkoj institucioneve, prezantoje se trajton 3700 ankesa në vit. Pse të gjithë largojnë duart kur del një gjë sensitive në opinionin publik dhe pastaj e merr në dorë Inspektori? Dhe kur Inspektori, pas një muaji, dy muajsh, jep rezultatet e atij inspektimi, thotë: "E mo, i iku koha kësaj tani, se doli tjetra. Kjo s'ishte gjë. Ou, nuk ishte gjë kjo. Pra, vajtën inspektorët atje, kontrolluan, i morën dosjet, të gjitha me radhë, problemet. Pra, kjo qënka gjë, vetëm kur ndodh, kur zbardhet gjëja, nuk përbën lajm kjo. Këtë e kam sugjerim timin, konkluzion timin që e kam nga të gjitha dëgjesat që kam dëgjuar këtu. Ndërsa për problemet që keni, sigurisht është një mangësi që ka në numrin e inspektorëve. Shpresoj që të plotësohen, por nuk mendoj se janë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për institucionin. Por nuk mendoj se ka çaluar puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë tek vakancat që ka, se në fund të fundit ju keni mjaftueshëm staf ndihmës edhe me atë numër inspektorësh që keni në dispozicion për t'iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të sistemit. Thënë të gjitha këto, nuk po them se pjesa tjetër e sistemit janë zi dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë është bardhë, sepse sistemi duhet të parë në 360 gradë. Unë për vete e kam thënë dhe këtu bashkohen me zotin Bylykbashi. E para njëherë, ne këtë nivel këshillash kemi. Nuk e di si e keni parë ju. Jam i bindur që dhe ju e keni parë me shqetësim, siç e kemi parë dhe ne. Nuk është mirë kur i përcillen mesazhe publikut ai nivel debati dhe diskutimi në organet kushtetuese të sistemit të drejtësisë, cila do të jetë natyra e debatit. Në fund të ditës, edhe mes kolegëve ka debate, edhe sidomos mes juristëve, por publikut do të duhet t'i përcillet një tjetër mesazh nga organet e e sistemit të drejtësisë, se pastaj nëse do të shkojmë tek ajo që ju thatë, që dhe drejtësia, sistemi, dhe kur flas për sistemin, po flas për lëndën e sistemit, për ata që japin drejtësi dhe ata që hetojnë. Nëse magjistratët që prodhon shkolla reflektojnë, dakord që reflektojnë nivelin që ka shoqëria, por unë e di që të qenurit gjyqtar është profesion i elitave të mendimit juridik. Më kupton? Edhe të qenurit prokuror, sepse dhe shoqëria ka shtresat e veta. Unë, të paktën, kështu e di që thuhet. Një shprehje që na kishin thënë, që ligji është serioz dhe ne e morëm me seriozitet këtë punë kur shkuam në drejtësi. Kështu duhet të jetë. Tani, po në qoftë se kemi rënë në këto pozita, duhet ta shohim shumë më thellë se ku e kemi defektin dhe këtu pastaj vijmë atje ku e nisa, duke filluar nga ne, edhe ju në një tryezë të përbashkët, po jo duke e parë problemin tek tjetri, se kështu nuk zgjidhim asgjë. Ulet dhe diskutohet parlamenti, ekzekutivi, gjyqësori, ore çfarë do të bëjmë me të ardhmen e sistemit. Sigurisht që sistemi që kemi nuk është ai që ishte. Ka shumë për shkak të asaj reforme që bëmë. Kemi ndonjë indikator të matshëm, sidomos sa i takon, organeve të posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por nuk është ky sistemi. Në qoftë se ata trajtojnë një lëndë me 700 dosje në vit, se nuk e kam tani, do ta shoh kur të vijnë, prokurori i përgjithshëm këtu tha: "Kam 66000 çështje në vit, mosfillime, plus çështje të reja. E di ç'do të thotë 66.000 kallëzime që shkojnë në 13 prokurori të juridiksionit të përgjithshëm?

*Janë qytetarë shqiptarë, qytetarë shqiptarë që i janë drejtuar prokurorisë dhe presin nga ajo trupë prokurorësh, ndërsa ne e shohim ngushtë këndin. Gjithsesi, ndjesë se u zgjata, por ju përfaqësoni një institucion që, kur e konceptuam reformën në drejtësi, thamë: “Garancitë e sistemit, garancia e sistemit do të jetë inspektori i lartë i drejtësisë,” dhe prandaj e nxorëm nga jashtë Këshillin të Lartë të Drejtësisë të dikurshëm apo pushtetit të ministrit të drejtësisë, se kur flasim për ministrin e drejtësisë, nuk duhet të marrim në konsideratë reformën në drejtësi. Ministri i drejtësisë është duart lart edhe thotë që merret me politikën e sistemit, po dhe se ç’me politika sistemi merret, këtë s’e di. Po statistikën e prodhon, i mbledh në mënyrë manuale sa këtu, sa atje, dhe publikon një statistikor vjetor aty dhe përfaqëson, paraqet, mbron dhe buxhetin e organeve të drejtësisë. Në fakt, ata e negociojnë vetë me Ministrinë e Financave, po i ka mbetur kjo punë që e mbron Ministri i Drejtësisë. Unë për këtë diskutim jam, për këtë diskutim, sepse po t’i shohësh raportet, të gjithë organet e drejtësisë që i kanë sjellë raportet në komision, raportet nga pikëpamja e metodologjisë edhe e punës që pasqyrojnë treguesit, se shifrat nuk ndrohen. Në qoftë se ke bërë 10 inspektime, 10 inspektime janë shkruar aty. Unë s’t’i bëj dot as 11, as 12, po as pesë. Raportet i marrim në rregull që të vëmë gishtin aty ku janë plagët e sistemit. Unë pres këtë lloj bashkëpunimi dhe reflektimi njëkohësisht, por duke mos vënë gishtin se ku është fajtori, se fajtor në fund të ditës jemi të gjithë për këtu ku kemi mbërritur. Edhe unë, bashkë me zotin Bylykbashi, që kam qenë anëtar i Komisionit të Reformës në Drejtësi nga dita një dhe deri sot që jam kryetar i Komisionit të Ligjeve. Ky më pak, sepse ky thotë: “Unë kam qenë deri te ndryshimet kushtetuese dhe te ligji i SPAK-ut. Më vonë thotë: S’kam qenë, thotë unë. Jo, po a kupton? S’kam qenë – thotë. Edhe mirë, por po ke prek pak... si ke qenë tek të gjitha, si ke qenë te dy, në fund fare, barazim jemi, se ky ka ngritur dorën te Kushtetuta dhe këtu i ka hapur rrugën të gjithave. Këto kisha unë, zoti inspektor.*

**Deputet Oerd Bylykbashi:** Nëse mundesh, pra jo me përbindje, pra nga dallojnë këto ankesat dhe te komenti që mund të bëni, nëse e mora përgjigjen, nga dallon gjithë ky volum ankesash çfarë është problemi, që është i gjyqësorit, mungesë kapacitetesh, dembelizëm, po deshe, etj., dhe çfarë është që vjen nga jashtë. Pra, gjithë ky numër i madh reflektohet në mosfunksionimin e të gjithëve, për shkak se po mbytet sistemi i drejtësisë me padrejtësi që vijnë nga mënyra si funksionon shteti. Pra, nga dallon kjo gjë?

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** Shiko, kjo do të na e kthente diskutimin dhe njëherë nga e para. Shiko, janë të shkruara aty. Unë e pashë tipologjinë e ankesave. Po t’i shohësh edhe po t’i ndash në grup ankesat, pra në mënyrë grupore, ankesat e të njëjtit lloj, dihen ato që tha zoti Metani, janë ankesat. Po sigurisht e tha ai që infrastruktura e godinave është një nga...është një indikator, edhe ne e kemi pranuar atë që ka përplasje, përplas qytetari, shkon në drejtësi. Por gjithsesi, zoti Metani, një fjalë të fundit përpara se unë t’ju falenderoj dhe të mbyllim mbledhjen.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Së pari, faleminderit relatores për punën dhe për mirëkuptimin për situatën në të cilën gjendet Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për problematikat, sfidat edhe arritjet që ka pasur. E vlerësoj natyrisht edhe mbështetjen e Komisionit, pikërisht për këtë lloj diskutimi që ne kemi nevojë të bëjmë bashkë. Së dyti, vetëm një përgjigje për zotin Bylykbashi. Çështja është që ky është perceptim dhe kjo është analizë që ne nuk e bëjmë. Unë mund të kem mendimet e mia për këtë dhe kam padyshim mendimet e mia, po që rezervohem t’i them, se mund të bëhen edhe politike pastaj. Edhe është një gjë që nuk e zgjidh.

Situata në drejtësi është ajo që është, por unë do të kërkoja me shumë përlulje, që të jemi super të kujdesshëm, e para për të analizuar sistemin dhe e dyta për zgjidhjet dhe zgjedhjet që do bëjmë për të rregulluar dhe për të ndryshuar gjërat. Nuk do doja që të marrim, të japim mendime apo të marrim vendime për shkak të një emocioni të situatës së sotme dhe prandaj bie shumë dakord me tryezën që ju mendoni që të bëni. Dhe që nga dita një, kam kërkuar raport shumë më të ngushtë si Inspektori i Lartë i Drejtësisë me Komisionin e Ligjeve, apo me këdo tjetër, për të zgjidhur pikërisht këto situata, ose për t’i dhënë drejtim me ca mendime kësaj situatë në të cilën gjendet sistemi i drejtësisë sot, që jo domosdoshmërisht është e keqe. Unë ndaj tjetër mendim se probleme ka sa të duash, po shpeshherë e keqja mbizotëron mbi atë që po ndodh realisht. Drejtësia që kemi sot nuk është ajo që kishim. Por tani ne na ka rënë të zgjidhim këto probleme që kemi. Minimalisht tani sistemi ka më shumë pavarësi dhe për mua është shumë e rëndësishme kjo, sepse ju e përmendët që e hoqët Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga institucionet, që edhe mund ta njollosnin pavarësinë e magjistratëve dhe e bëtë institucion të pavarur. Po pikërisht kjo është arritja më e madhe, mendoj, për reformën në drejtësi, që e ka krijuar institucion të pavarur. Në këndvështrimin tim, edhe pse mund të duket arrogante, është një institucion që po performon në mënyrë të pavarur, pikërisht për atë mision që i ka dhënë Kushtetuta dhe ju, që bëtë atë ndryshim kushtetues, sepse shpeshherë merret si e mirëqenë kjo, po në fakt nuk është. Është ndoshta detyra, një nga detyrat më të vështira që duhet të ketë një person, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. S’po flas për vete, sepse e thashë edhe më parë qasjen time, por është i vetmi person që ka të drejtën e firmës për të filluar ose jo një hetim disiplinor ndaj magjistratit, që nëse nis për shkak të motivimit publik, pra në kundërshtim me Kushtetutën, kthehet në mjet shantazhi për magjistratët, cka nuk u shërben padyshim as qytetarëve, as sistemit. Reagim tjetër, jam dakord me ju, nuk mund të ketë një institucion që funksionon dhe disa që nuk funksionojnë. O jemi të gjithë që funksionojmë, pra ose e meritojmë të gjithë ose nuk e meritojmë të gjithë, se është shumë e rëndësishme. Dhe kjo nuk lidhet thjesht me individin që është titullar, lidhet me performancën e organeve të qeverisjes në raport me qytetarët. Prandaj, për këtë arsye them ose do performojmë të tërë, ose nuk do performojmë të tërë. Në lidhje me disiplinën në punë të magjistratëve, në fakt, rreth para një viti, edhe unë këtë perceptim kisha dhe për këtë arsye ne menduam një inspektim tematik, pikërisht për të parë disiplinën në punë të magjistratëve, jo për të prekur pavarësinë, siç reagojnë shpeshherë ndoshta magjistratët dhe Këshillat. Është shumë e vështirë të matësh disiplinën 8 orë të magjistratit si gjyqtar, si prokuror, për shumë arsye. Por filluam inspektim tematik për planifikimin e seancave gjyqësore dhe kryerjen e seancave gjyqësore. Në 10, kam përshtypjen, nëntë apo 10 gjykata të vendit, pikërisht për ta kontrolluar disiplinën e magjistratëve me mënyrën si planifikojnë seancat gjyqësore dhe si e ndjekin këtë kalendër planifikimi të seancave gjyqësore. Pikërisht për t’i dhënë magjistratëve e para mesazhin që disiplina në punë kontrollohet nëpërmjet një forme që e parashikon kushtetuta dhe ligji, pa ceduar dhe pa cënuar pavarësinë e tyre. Ky inspektim tematik ka mbaruar, është në faqe, mund t’ua bëjmë të ditur gjithsesi. Kemi dalë me një numër të madh rekomandimesh, kryesisht për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe patjetër që do ndjekim ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Pra, do e thojë që çdo shqetësim që del në publik, ne mundohemi ta adresojmë. Jo gjithmonë del ashtu siç perceptohet në publik, sepse nga të dhënat që kanë dalë nga ky inspektim tematik nuk janë tërësisht, ashtu si mendohet që gjyqtarët e prokurorët kanë një disiplinë ose s’kanë disiplinë fare në punë.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Ka problematika, për këtë arsye kemi dalë me rekomandime, por është një gjë që duhet balancuar mirë. Jam shumë dakord me rolin publik që duhet të ketë Inspektori i Lartë i Drejtësisë në raport me inspektimet e kryera, jo thjesht për të evidentuar punën që është bërë, sepse puna është aty, ashtu sic thatë ju. Kush do ta shohë, do ta shohë; kush nuk do ta shohë, nuk do ta shohë. Mund të dalësh dhe me daulte, domethënë. Po nuk është ky shqetësimi.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Jo, jo, zoti Inspektor, unë kam një problem. Kur të bëra ato sugjerime, mendoj që duhet të marrin përgjigje ata që e shohin dhe e lexojnë, po e transmetojnë ndryshe, se këtë e kam unë, këtë e kam shqetësim. Prandaj them duhet të ndryshoni qasje.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Ndoshta, por unë jam, shiko, ndoshta keni ju...!

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Edhe pse ju mund të më thoni që ata që nuk duan ta lexojnë ashtu siç është, kurrë s'kanë për ta lexuar, dhe sikur të thoni ju... Problemi është raporti me publikun.*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:** Për mua është e rëndësishme që veprimtaria e institucioneve të jetë transparente. Pra, nuk ka asnjë gjë që bën Inspektori i Lartë i drejtësisë, që nuk është në faqen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, faqen e internetit që ka Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nga inspektimi tematik në çdo veprimtari dhe çdo kontroll që i bëhet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, meqë ra fjala, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është nënshtruar çdo kontrolli të mundshëm nga KLSH, nga Ministria e Financave, nga Komisioni i Shërbimit Civil, nga çdo institucion që kontrollon veprimtarinë, nga Drejtoria e Arkivave, nga ku di unë, se s'më kujtohet. Dhe të gjitha, e para kontrollet janë në faqe dhe të gjitha kontrollet nuk kanë evidentuar asnjë problematikë në veprimtarinë e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që për mua është themelore, sepse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është vetëm organ drejtësie, është institucion publik në radhë të parë. Ka edhe performancën si institucion publik. Së dyti, në raport me thelbin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, prapë është në faqe një inspektim i kryer nga Këshilli i Gjyqësor Spanjoll, nga ekspertë, nga inspektorët e Këshillit Gjyqësor Spanjoll për procedimet disiplinore që ka kryer Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe kanë dhënë, kanë marrë të gjitha procedimet disiplinore që ka bërë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i kanë analizuar dhe kanë dalë me dy rekomandime: që Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka raportet hetimore të procedimeve voluminoze, pra duhet të jetë më të shkurtra dhe e dyta, lloji i masave që kërkohet, ka lidhje me pavarësinë e gjyqtarëve. Vëren se nuk duhet kërkuar ulja e pagës si masë disiplinore, sepse preket dhe familja. Pra, dua të them, institucioni është i kontrolluar në çdo fazë, në çdo moment, nga kushdo që e ka kompetencën ta kontrollojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe të gjitha janë në faqe. Tani, për ta bërë publike këtë gjë, ndoshta keni drejtë. Unë nuk kam dashur të luaj asnjëherë rolin, se nuk është roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të tregojë çfarë ka bërë,

ndërkohë të tjerët kanë problematikat e veta, sepse edhe ne kemi problematikat tona, padyshim, edhe ne kemi shumë gjëra për të rregulluar, sepse dinamika e problematikave me të cilat hasemi, duhet të jesh edhe fleksibël për të ndryshuar metodologjinë e punës, praktikën e punës, reagimin e shpejtë për gjërat që ndodhin, por të gjitha janë pjesë e një balance që ne e bëjmë çdo ditë. Për shembull, vërtetë nuk është rritur numri i inspektorëve, se janë ata që janë, por numri i inspektimeve tematike është rritur dhe pyetja është si ka mundësi, sepse edhe profesionalizmi i inspektorëve, trajnimi, eksperiencia që ata fitojnë, i bën ata më të zhdërvjellët për të kryer ato inspektime tematike që ka nevojë institucioni. Pra, si me thënë, shikohet dinamika dhe zhvillimi i institucionit, por për ta bërë publike këtë, e marrim me shumë kënaqësi edhe si sugjerim, edhe personalisht do e konsultojmë edhe me kolegët, domethënë, por hezitimi im ka qenë gjithmonë që nuk do të doja, sepse jam i mendimit o janë të gjitha institucionet bashkë ose s'janë. Kjo është dilema ime. Duke ju falenderuar edhe njëherë për mirëkuptimin, e kam bërë shpeshherë këtë ftesë, po e bëj prapë. Do të doja që anëtarët e këtij komisioni të vinin e takonin edhe vetë inspektorët, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të parë ndoshta edhe ndjeshmërinë që ata kanë.

**Kryetari i Komisionit Ulsi Manja:** *Jo, shumë faleminderit zoti Metani edhe për ftesën për të ardhur dhe t'i shohim vetë, pse jo të kemi edhe një vizitë në institucionin që ju drejtoni. Se me thënë të drejtën, ne si komision, ngaqë na ka mbytur puna këtu, edhe pse e kemi kompetencë të bëjmë monitorime dhe mbikëqyrje parlamentare, ndoshta do i bie ta bëjmë me institucionin tuaj si fillim. Me kënaqësi do vijmë. Unë dua t'ju falenderoj sot për raportimin. Siç do t'i kërkoja zonjës Bylykbashi që pjesë të projektrezolutës që do të bëjmë për institucionin e zotit Metani për vitin 2026, ne të reflektojmë edhe disa nga problematikat dhe shqetësimet që edhe dolën në këtë raportim dhe më pas, besoj në datën 3 korrik, të premten, ne ta kemi gati projektrezolutën që ta miratojmë. Më pas të vijojë puna tek Komisioni i Nismave, ku do të raportoni për zbatimin e rezolutës së vitit që kaloi, edhe pse ajo u miratua gati në fund të vitit, dhe për rekomandimet që mund të kenë dalë nga monitorimi periodik dhe që do të duhet të bëhen pjesë e tekstit final të projektrezolutës që do të shkojë në Kuvendin e Shqipërisë. Unë dua t'ju falenderoj dhe për punën që bëni dhe bashkohem me të gjithë sa ju thatë në këtë mbledhje komisioni, duke e parë tërësisht sistemin e drejtësisë, arritjet, sfidat, por dhe problematikat si shqetësim të përbashkët. Vetëm kështu mund t'i zgjidhim, ndryshe po hyjmë pastaj për të parë secili pjesën e vetë. Unë jam i bindur që nuk do të bëjmë asgjë, vetëm se problemi do të ngelet aty pa përgjigje dhe pa zgjidhje. Dua të falenderoj dhe kolegët e mi deputetë sot për këtë ditë të gjatë pune dhe ne do të vazhdojmë. Kemi akoma një ditë më të gjatë, sepse kemi dhe jemi dhe në seancë plenare. Dua të falenderoj edhe stafin e Kuvendit që na mundëson zhvillimin e këtyre mbledhjeve, zhvillimin normal të mbledhjeve tona, por dhe publikun që jam i bindur që raportimet e institucioneve të drejtësisë i ndjek me shumë interes dhe këtë e kemi nga sondazhet që kemi sa i raportojnë institucionet tuaja, sidomos drejtësia, është pushtet shumë i ndjeshëm. Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë të gjithëve.*



## RUBRIKA/ PRAKTIKANTËT FLASIN!



**Rosela Hida** është një studente e vitit të tretë në programin Bachelor në University of Law, e cila udhëhiqet nga një pasion i madh për studimin e ligjit dhe ndikimin e tij të drejtpërdrejtë tek individët dhe shoqëria në përgjithësi. Gjatë rrugëtimit të saj akademik, ajo ka ndjekur me përkushtim lëndë mësimore që kanë thelluar interesin e saj për sistemin ligjor, duke përmirësuar ndjeshëm kuptimin mbi mënyrat e shumta se si ligji formësohet dhe ndikon në jetën e përditshme. Përtej përgatitjes teorike, Rosela ka pasur privilegjin të fitojë një përvojë të vlefshme praktike në terren, duke u angazhuar në një Crown Court si dhe në tre studio ligjore të njohura në Londër. Këto mundësi të rëndësishme i kanë ofruar asaj një kuptim shumë më të thelluar të funksionimit praktik të sistemit të drejtësisë, kanë forcuar aftësitë e saj të komunikimit profesional e të punës në grup, si dhe kanë nxitur zhvillimin e një etike të fortë e të palëkundur pune.

### 1. Cfarë ju shtyu të zgjidhni Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të zhvilluar praktikën?

Zgjedha Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të kryer praktikën time profesionale, pasi e konsideroj këtë institucion si një nga institucionet më prestigjioze dhe më të rëndësishme brenda sistemit të drejtësisë Shqiptare. Roli i ILD-së në garantimin e integritetit, llogaridhënies dhe funksionimit të duhur të sistemit gjyqësor e bën atë një institucion veçanërisht të vlefshëm për zhvillimin profesional të një studenti të drejtësisë. Për më tepër, kryerja e praktikës në këtë institucion më dha mundësinë të fitoj njohuri të drejtpërdrejta mbi funksionimin e sistemit gjyqësor Shqiptar, duke përfshirë procedurat administrative dhe disiplinore, si dhe zbatimin praktik të parimeve juridike. Puna në një institucion të tillë të dalluar më ndihmoi të lidh më mirë studimin akademik me praktikën ligjore, duke zhvilluar më tej aftësitë e mia analitike, profesionale dhe praktike juridike. Besoj se kjo përvojë ka thelluar ndjeshëm kuptimin tim mbi kuadrin ligjor shqiptar dhe ka forcuar angazhimin tim për të ndjekur një karrierë në fushën e drejtësisë, duke më pajisur njëkohësisht me njohuri dhe përvojë të vlefshme për zhvillimin tim të ardhshëm profesional.

### 2. Cila ishte pershtypja juaj e parë kur nisët praktikën?

Kur nisa praktikën time profesionale, pershtypja ime fillestare për institucionin ishte shumë pozitive, pasi u mirëpritë ngrohtësisht nga stafi, me qasjen e tyre mbështetëse dhe të afërueshme më bënë menjëherë të ndiheshja e përfshirë në mjedisin e punës. Që në fillim, vura re një ambient pune profesional, të mirëstrukturuar dhe shumë të organizuar, ku komunikimi i qartë, respekti i ndërsjellë dhe bashkëpunimi efektiv ndërmjet kolegëve ishin të dukshme në funksionimin e përditshëm të institucionit. Kjo atmosferë pozitive dhe inkurajuese jo vetëm që forcoi motivimin tim, por gjithashtu më nxiti të angazhohem më aktivisht në detyrat e caktuara, të qasem me më shumë përkushtim ndaj përgjegjësisë të mia dhe të shfrytëzoj plotësisht këtë përvojë, si në aspektin e zhvillimit profesional, ashtu edhe në thellimin e kuptimit tim mbi rolin e institucionit brenda sistemit të drejtësisë.

### 3. A pati ndonjë moment apo detyrë që ju bëri më shumë pershtypje?

Një nga momentet që bëri më shumë pershtypje ishte kur pata mundësinë të vëzhgoja shqyrtimin e një anekse të paraqitur nga një qytetarë e cila shprehu shqetësimet e saj në lidhje me një çështje që lidhet me sistemin e drejtësisë. Ky moment më ndihmoi që të kuptoj më mirë rëndësinë e Zyres së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në dëgjimin, vlerësimin dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve, si dhe rolin e saj në forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

### 4. Cfarë do të merrni me vete nga kjo eksperiencë?

Nga kjo përvojë, do të marr me vete një kuptim shumë më të thellë dhe më të bazuar në praktikë të sistemit ligjor Shqiptar dhe të funksionimit të përditshëm të institucioneve të drejtësisë. Përtej njohurive teorike të fituara gjatë studimeve të mia, kjo praktikë më ka lejuar të vëzhgoj se si parimet juridike zbatohen në praktikë,

duke ndihmuar në kapërcimin e hendekut midis mësimi akademik dhe realitetit institucional. Ajo më ka ofruar gjithashtu një ekspozim të vlefshëm profesional brenda një mjedisi formal gjyqësor, duke forcuar aftësitë e mia analitike dhe të të menduarit kritik. Po aq e rëndësishme, ajo ka përforcuar vlerësimin tim për rëndësinë thelbësore të profesionalizmit, sjelljes etike, diskrecionit dhe ndjenjës së fortë të përgjegjësisë në profesionin juridik, të cilat i konsideroj si cilësi thelbësore për zhvillimin tim të ardhshëm profesional.

#### 5. Cili ka qënë aspekti më interesant i kësaj eksperience për ju?

Aspekti më interesant i kësaj përvojë për mua ishte vëzhgimi i drejtpërdrejtë i trajtimit të një ankese të paraqitur nga një qytetarë, e cila shprehte shqetësimet e saj lidhur me një çështje të lidhur me sistemin e drejtësisë. Ky ekspozim më dha një kuptim më të thelluar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe funksionit të saj themelor në pranimin, shqyrtimin dhe trajtimin në mënyrë sistematike të ankesave të publikut në një mënyrë të paanshme dhe metodike. Gjithashtu, kjo përvojë ndriçoi më tej rëndësinë më të gjerë kushtetuese të institucionit në garantimin e llogaridhënies së gjyqësorit dhe në forcimin e besimit të publikut në integritetin dhe transparencën e sistemit të drejtësisë.

#### 6. Cfarë keni mësuar gjatë qëndrimit në ILD, që nuk e kishit njohur më parë?

Gjatë qëndrimit në ILD, mësova më shumë mbi funksionimin e sistemit ligjor Shqiptar, procedurat juridike dhe rolin e institucioneve të drejtësisë – fusha për të cilat më parë kisha njohuri praktike të kufizuara. Kjo përvojë më ndihmoi të kuptoj më mirë zbatimin praktik të ligjit dhe rëndësinë e rolit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në garantimin e integritetit dhe llogaridhënies brenda sistemit të drejtësisë. Jam mirënjohës që pata mundësinë të fitoj këtë njohuri në një institucion kaq prestigjioz si Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

#### 7. Si do ta përshkruanit me pak fjalë atmosferën e punës në institucion?

Atmosfera e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ishte shumë pozitive dhe profesionale. Që në fillim të praktikës sime, u mirëpritë nga stafi, i cili ishte i gatshëm të më mbështeste dhe të më përfshinte në mjedisin e punës. Ndërmjet kolegëve ekziston me një kulturë e qartë bashkëpunimi, respekti të ndërsjellë dhe komunikimi të hapur, e cila kontribuonte në krijimin e një atmosfere pozitive, të disiplinuar dhe motivuese, të favorshme për të mësuar dhe për zhvillim profesional.

#### 8. Cfarë mesazhi do t'u jepnit studenteve të tjerë, ose të rinjve që dëshirojnë të ndjekin një praktikë profesionale në institucionet e drejtësisë, apo në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë?

Mesazhi që do t'u jepja studentëve të tjerë që dëshirojnë të kryejnë një praktikë profesionale në institucionet e drejtësisë, veçanërisht në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është që ta shfrytëzojnë këtë mundësi me përkushtim dhe angazhim. Përvoja praktike i ndihmon studentët të lidhin njohuritë teorike të fituara në universitet me zbatimin e tyre në mjedise reale profesionale. Vetëm përmes përfshirjes në një ambient profesional, studentët mund të fitojnë një kuptim më të mirë të mënyrës se si funksionon sistemi ligjor dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme në fushën e drejtësisë.





### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Korrik 2026**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **7 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkesë të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuarësin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit [elis.kuci@ild.al](mailto:elis.kuci@ild.al)

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Korrik 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **13 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarësit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

## ILD NË TWITTER



**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD Albania

"Nëse rruga drejt përfundimit të negociatave me BE, jo vetëm si një proces teknik por edhe si proces vlerash rezulton e suksesshme, edhe sistemi i drejtësisë ka pjesën e vet të meritës..."#ILD  
#ArturMetani 📌  
[ild.al/sq/2026/07/16/...](http://ild.al/sq/2026/07/16/...)



**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD Albania

Kënaqësi takimi me Prokurorin e Përgjithshëm pranë Gjykatës së Lartë  Edwin Bleichrodt. Shkëmbyem eksperiencë mbi përgjegjëshmërinë e magjistratëve e inspektimit. Mirënjohje ambasador [@ReinoutVos](#) për vëmendjen e dedikuar ndaj institucioneve të drejtësisë.

[ild.al/sq/2026/07/15/...](http://ild.al/sq/2026/07/15/...)



**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD Albania

🇧🇪 Përpunimi i javor i ankesave në #ILD 🇮🇹

- ✅ 9381 të konfirmuara
- ✅ 6990 të trajtuara
- ✅ 2391 në proces trajtimi
- ✅ 196 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 55 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na tregoni 🇮🇹🇧🇪

[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...  
@ILD Albania

Raporti për Shtetin e së Drejtës 2026 për  
Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. #ILD 🇷🇺  
#KomisioniEvropian 🇪🇺 #raport 📌



**Inspektorai i Lartë** i Drejtësisë vëzhdon të jetë funksional, por përparimet synoheshin në një numër të lartë vendesh vakante për magjistrat-inspektorë në vitin 2025, inspektor i Lartë i Drejtësisë regjistroi 1792 shtetë të kësaj detyre trajpui të tërë shtetit. Aktualisht vendet të një 20 inspektorë janë në detyrë.

[illegible]

Inspektorii i Lartë i Drejtësisë mënjanë një metodologji të re për kontrollin e pasurisë dhe të figurës, si edhe shpallin tërheqjen e paktit të ri ligjor për të integruar më tej standardet e vendosura nga procesi i miratimit të kësaj (vetëqesues) në procedurë dhe të të integruar.



March 17, 2020  
20-02100-000 (a)

COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT  
Title: Study on the Impact of the COVID-19 Pandemic on the EU Economy

Country Chapter on the role of civil education in Ukraine

Accompanying the document

Communication from the Committee to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions

2010-2011

The role of civil education in the European Union

|               |               |               |
|---------------|---------------|---------------|
| 2010-2011-001 | 2010-2011-001 | 2010-2011-001 |
| 2010-2011-002 | 2010-2011-002 | 2010-2011-002 |
| 2010-2011-003 | 2010-2011-003 | 2010-2011-003 |
| 2010-2011-004 | 2010-2011-004 | 2010-2011-004 |
| 2010-2011-005 | 2010-2011-005 | 2010-2011-005 |
| 2010-2011-006 | 2010-2011-006 | 2010-2011-006 |
| 2010-2011-007 | 2010-2011-007 | 2010-2011-007 |
| 2010-2011-008 | 2010-2011-008 | 2010-2011-008 |
| 2010-2011-009 | 2010-2011-009 | 2010-2011-009 |
| 2010-2011-010 | 2010-2011-010 | 2010-2011-010 |
| 2010-2011-011 | 2010-2011-011 | 2010-2011-011 |
| 2010-2011-012 | 2010-2011-012 | 2010-2011-012 |
| 2010-2011-013 | 2010-2011-013 | 2010-2011-013 |
| 2010-2011-014 | 2010-2011-014 | 2010-2011-014 |
| 2010-2011-015 | 2010-2011-015 | 2010-2011-015 |
| 2010-2011-016 | 2010-2011-016 | 2010-2011-016 |
| 2010-2011-017 | 2010-2011-017 | 2010-2011-017 |
| 2010-2011-018 | 2010-2011-018 | 2010-2011-018 |
| 2010-2011-019 | 2010-2011-019 | 2010-2011-019 |
| 2010-2011-020 | 2010-2011-020 | 2010-2011-020 |
| 2010-2011-021 | 2010-2011-021 | 2010-2011-021 |
| 2010-2011-022 | 2010-2011-022 | 2010-2011-022 |
| 2010-2011-023 | 2010-2011-023 | 2010-2011-023 |
| 2010-2011-024 | 2010-2011-024 | 2010-2011-024 |
| 2010-2011-025 | 2010-2011-025 | 2010-2011-025 |
| 2010-2011-026 | 2010-2011-026 | 2010-2011-026 |
| 2010-2011-027 | 2010-2011-027 | 2010-2011-027 |
| 2010-2011-028 | 2010-2011-028 | 2010-2011-028 |
| 2010-2011-029 | 2010-2011-029 | 2010-2011-029 |
| 2010-2011-030 | 2010-2011-030 | 2010-2011-030 |
| 2010-2011-031 | 2010-2011-031 | 2010-2011-031 |
| 2010-2011-032 | 2010-2011-032 | 2010-2011-032 |
| 2010-2011-033 | 2010-2011-033 | 2010-2011-033 |
| 2010-2011-034 | 2010-2011-034 | 2010-2011-034 |
| 2010-2011-035 | 2010-2011-035 | 2010-2011-035 |
| 2010-2011-036 | 2010-2011-036 | 2010-2011-036 |
| 2010-2011-037 | 2010-2011-037 | 2010-2011-037 |
| 2010-2011-038 | 2010-2011-038 | 2010-2011-038 |
| 2010-2011-039 | 2010-2011-039 | 2010-2011-039 |
| 2010-2011-040 | 2010-2011-040 | 2010-2011-040 |
| 2010-2011-041 | 2010-2011-041 | 2010-2011-041 |
| 2010-2011-042 | 2010-2011-042 | 2010-2011-042 |
| 2010-2011-043 | 2010-2011-043 | 2010-2011-043 |
| 2010-2011-044 | 2010-2011-044 | 2010-2011-044 |
| 2010-2011-045 | 2010-2011-045 | 2010-2011-045 |
| 2010-2011-046 | 2010-2011-046 | 2010-2011-046 |
| 2010-2011-047 | 2010-2011-047 | 2010-2011-047 |
| 2010-2011-048 | 2010-2011-048 | 2010-2011-048 |
| 2010-2011-049 | 2010-2011-049 | 2010-2011-049 |
| 2010-2011-050 | 2010-2011-050 | 2010-2011-050 |
| 2010-2011-051 | 2010-2011-051 | 2010-2011-051 |
| 2010-2011-052 | 2010-2011-052 | 2010-2011-052 |
| 2010-2011-053 | 2010-2011-053 | 2010-2011-053 |
| 2010-2011-054 | 2010-2011-054 | 2010-2011-054 |
| 2010-2011-055 | 2010-2011-055 | 2010-2011-055 |
| 2010-2011-056 | 2010-2011-056 | 2010-2011-056 |
| 2010-2011-057 | 2010-2011-057 | 2010-2011-057 |
| 2010-2011-058 | 2010-2011-058 | 2010-2011-058 |
| 2010-2011-059 | 2010-2011-059 | 2010-2011-059 |
| 2010-2011-060 | 2010-2011-060 | 2010-2011-060 |
| 2010-2011-061 | 2010-2011-061 | 2010-2011-061 |
| 2010-2011-062 | 2010-2011-062 | 2010-2011-062 |
| 2010-2011-063 | 2010-2011-063 | 2010-2011-063 |
| 2010-2011-064 | 2010-2011-064 | 2010-2011-064 |
| 2010-2011-065 | 2010-2011-065 | 2010-2011-065 |
| 2010-2011-066 | 2010-2011-066 | 2010-2011-066 |
| 2010-2011-067 | 2010-2011-067 | 2010-2011-067 |
| 2010-2011-068 | 2010-2011-068 | 2010-2011-068 |
| 2010-2011-069 | 2010-2011-069 | 2010-2011-069 |
| 201           |               |               |




**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Përpunimi i javor i ankesave në #ILD 🏛️

- ✅ 9443 të konfirmuara
- ✅ 7035 të trajtuara
- ✅ 2408 në proces trajtimi
- ✅ 208 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 56 kërkesa për procedim disiplinor

❓ Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🗣️ 🍌

[ild.al/sq/ankete/](#)



|                                       |                                              |                                                  |                                        |
|---------------------------------------|----------------------------------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>9,443+</b><br>Confirmed Complaints | <b>7,035</b><br>Processed Complaints         | <b>2,408</b><br>Complaints in the review process | <b>150</b><br>Investigated allegations |
|                                       | <b>208</b><br>Complaints to the verification | <b>56</b><br>Requests for disciplinary           |                                        |

*This information is updated every monday*



**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD Albania

Sot në Komisionin për Nismat Qytetare  
Bashkëpunimin e Mbikëqyrjen Institucionale mbi  
rezolutën e Kuvendit për vitin 2025. #ILD 📌  
[ild.al/sq/2026/07/07/...](http://ild.al/sq/2026/07/07/...)

Korrik 2026


Të gjitha të drejtat e  
rezervuara  
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

## KONTAKT

Web: [ild.al](http://ild.al)  
Tel: +35542217217  
Email: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!